# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5739
E shtunë, 30 mars 2019
çmimi 0.40 €


## Shqipëria 10 vjet në NATO, tregon fuqinë ushtarake

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", DHURATA HOXHA FAQE 4-5

# Kosova e meriton liberalizimin e vizave



## - Presim deklarimin e Këshillit të Ministrave për liberalizimin e vizave

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se votimi i Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën është argument i rikonfirmimit të përmbushjes së kritereve. Ajo ka thënë se tani vendimi për liberalizimin e vizave gjendet në duart e vendeve anëtare të Këshillit të Ministrave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxha ka deklaruar se pret nga Këshilli i Ministrave të deklarohet pro liberalizimit pas zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Ajo ka theksuar se vendimi për heqjen e vizave mund të merret në takimin e radhës, në rast se do të ekzistojë klimë pozitive e vendeve veç e veç për këtë çështje. Ministrja Hoxha ka thënë se deri atëherë do të punohet me vendet hezituese për t'i bindur për të arriturat e Kosovës

## LEKAJ SQAROHET ME AMBASADORIN ZVICERAN

Një ditë pasi kishte kërkuar largimin e tij nga Kosova, ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka pritur në takim ambasadorin e Zvicrës, Jean Humbert Lebet. Lekaj ka thënë se në asnjë çast nuk ka kërkuar largimin e ambasadorit zviceran por, sipas tij, mediet e kanë nxjerrë nga konteksti deklaratën e tij. Ndërsa ambasadori Lebet ka thënë se çdo vërejtje që Zvicra bën, shteti i



Kosovës duhet ta pranojë si një vërejtje nga një shtet mik FAQE 3



## Krasniqi: Kjo KQZ do t'i rrënojë zgjedhjet e lira dhe demokracinë

FAQE 7

### AKTUALE

**NOSTALGJIKËT E TAKSËS, DASHAMIRËT E KEKSIT DHE VIKTIMAT E SEKSIT!** F. 8

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



**PSD-ja KËRKON PËRFAQËSIM TË BARABARTË TË GRAVE DHE TË BURRAVE NË NIVELET VENDIMMARRËSE** F. 7

**POLICIA KONFISKON RRETH 16 KILOGRAMË MARIJUANË NË KUFI ME SHQIPËRINË** F. 6

### EKONOMI

**KEDS-i HAPI DYERT PËR NXËNËSIT** F. 9

**NISIN PUNIMET NË ZONËN EKONOMIKE NË VUSHTRRI** F. 9

### KULTURË

**MINISTRI GASHI: KOSOVA NË MESIN E VENDEVE TË TJERA NË BIENALE, SHTET SHUMË I RESPEKTUAR** F. 6



### SPORT

**BATATINA RIKTHEHET ME FITORE, DRITA MPOSHTI FERIZAJN** F. 13


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Shqipëria 10 vjet në NATO, tregon fuqinë ushtarake

Në shënimin e 10-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ka thënë se kemi të drejtën të ndihemi krenarë për punën që kemi bërë të gjithë bashkë në këta 10 vjet për ta justifikuar besimin që na u dha, për t'i modernizuar Forcat tona të Armatosura e për t'u kthyer në një faktor stabiliteti dhe një pikë referimi për sigurinë në rajon



TIRANË, 29 MARS (ER) - Republika e Shqipërisë ka festuar të premten 10-vjetorin e anëtarësimit në NATO në një ceremoni në Sheshin "Nënë Tereza" në Tiranë, ku morën pjesë presidenti i Republikës, Ilir Meta, kryeministri Edi Rama, ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, ministrja e Mbrojtjes e Italisë, Elisabeta Trenta, ajo e Maqedonisë së Veriut, Radmilla Shekerinska, ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Rrustem Berisha. Në këtë ceremoni morën pjesë, gjithashtu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral-brigade Bardhyl Kollçaku, homologët e tij turk e grek si dhe mjaft të ftuar. "Sot mbushen plot 10 vjet nga anëtarësimi i Shqipërisë në NATO. Për ne nuk është thjesht një ditëlindje. Është vërtet një ditë e bukur për t'u festuar por, mbi të gjitha, është një ditë kur të gjithë ne kemi të drejtën të ndihemi krenarë! Ne sot kemi të drejtën të ndihemi krenarë për punën e madhe që u bë për ta ftuar vendin tonë si anëtare të Aleancës më të madhe ushtarake në histori, por kemi të drejtën të ndihemi po aq krenarë edhe për punën që kemi bërë të gjithë bashkë në këta 10 vjet për ta justifikuar besimin që na u dha, për t'i modernizuar Forcat tona të Armatosura e për t'u kthyer në një faktor stabiliteti dhe një pikë referimi për sigurinë në rajon", ka thënë ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka.



Ndërkaq presidenti Ilir Meta ka thënë se anëtarësimi i Shqipërisë në NATO dhjetë vjet më parë përbën një nga ngjarjet më të mëdha në të gjithë historinë e Shqipërisë dhe të kombit shqiptar. "Një mirënjohje të veçantë dëshiroj t'ua përcjell të gjithë atyre burrave dhe grave në uniformë që udhëhoqën, punuan dhe realizuan këtë projekt transformues dhe integrues të Forcave tona të Armatosura ndër vite. Në këtë përvjetor historik dëshiroj ta shpreh mirënjohjen dhe falënderimin e veçantë ndaj të gjitha vendeve aleate dhe mike, të cilat e mbështetën me shumë besim anëtarësimin e Shqipërisë në NATO dhe kontribuuan në mënyrë të gjithanshme për modernizimin e Forcave tona të Armatosura", ka thënë Meta.

Ai ka falënderuar ish-presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, George W. Bush, i cili, sipas Metës, me vizitën e tij të paharruar në Tiranë, frymëzoi përpjekjet e përbashkëta për realizimin final të këtij qëllimi madhor. "E paçmuar mbetet mbështetja e jashtëzakonshme e të gjithë popullit shqiptar dhe mbarë spektrit politik e të gjitha qeverive të ndryshme ndaj këtij projekti madhor strategjik që u shërben interesave kombëtare si asnjë projekt tjetër", ka deklaruar Meta.

Ndërkaq, kryeministri Edi Rama tha se Shqipëria po përgatitet për ndërtimin e bazës së NATO-s në Kuçovë. Ai deklaroi se do të shndërrohet në një bazë të rilindur të NATO-s dhe se në saje të kësaj aleance, Ballkani zotëron sot një periudhë paqeje. "Por të mos e harrojmë asnjëherë presidentin Kenedi, i cili thoshte se paqja nuk është një e mirë e përditshme, por një proces i pandërprerë. Sot ne nuk jemi më armiq, por nuk duhet të harrojmë se ekstremizmi i dhunshëm i të ashtuquajturit shtet islamik, ISIS, nuk është mposhtur. Doktrina e tij nuk mund të mposhtet vetëm me forcën e armëve", u shpreh Rama. Sipas tij, integrimi i Malit të Zi më parë dhe Maqedonisë së Veriut më pas, ka krijuar një hapësirë të gjerë në Ballkan dhe ka forcuar stabilitetin e Ballkanit. "Në mënyrë që paqja e brishtë të mos sfidohet kurrë në të ardhmen, është e domosdoshme që edhe Kosova të bëhet më herët se vonë pjesë e integruar e NATO-s. Shqipëria beson shumë fortë se integrimi i Kosovës në familjen euroatlantike me ushtrinë e saj është një domosdoshmëri jo vetëm për Kosovën dhe Ballkanin, por për gjithë familjen euroatlantike. Përfshirja e Kosovës në NATO do të ishte një kapital i shtuar", tha Rama.

## DASH: Shqipëria gjithnjë e më shumë vend transit për drogat e forta

TIRANË, 29 MARS - Departamenti Amerikan i Shtetit i dorëzoi Kongresit raportin vjetor për strategjinë e luftës ndërkombëtare kundër narkotikëve. Në pjesën për Shqipërinë, DASh-i thotë se ky vend është njëkohësisht burim i kanabisit dhe, gjithnjë e më shumë, një vend transit për kokainën dhe heroinën. Në këtë raport që mbulon vitin 2018, Departamenti i Shtetit thotë se transiti i kanabisit si dhe i drogave të forta komandohet kryesisht nga elemente të krimit të organizuar që transferojnë droga të paligjshme nga vendet që janë burim për në tregjet evropiane. Vëllimi i konfiskimeve të drogës dhe arrestimet e lidhura me drogën në vitin 2018, thuhet në raport, ishin me rëndësi, të nxitura kryesisht nga bashkëpunimi i organeve ligjzbatuese me partnerët ndërkombëtarë, presioni ndërkombëtar në rritje dhe përpjekjet e Shqipërisë për të hyrë në Bashkimin Evropian. Sipas raportit, roli i Shqipërisë si burim apo treg për droga të paligjshme përtej kanabisit është i vogël, por ka pasur një rritje në konfiskimet e kokainës që kalon nëpër Shqipëri për në Evropë, përveç zbulimit të laboratorëve të përpunimit të heroinës dhe kokainës në Shqipërinë Veriore dhe Qendrore. "Grupet kriminale shqiptare e trafikojnë kokainën dhe heroinën drejt tregjeve evropiane nga vendet burimore në Amerikën e Jugut dhe Azi".

Në raport thuhet se korrupsioni në të gjitha nivelet e qev-




erisjes e kufizon efektivitetin e përgjithshëm të luftës kundër narkotikëve. Korrupsioni zyrtar, thuhet aty, është i përhapur dhe nxit një mjedis në të cilin trafikantët e drogës janë mjaft të aftë të veprojnë pa u ndëshkuar.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka pritur në takim ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jean Humbert Lebet

# Lekaj sqarohet me ambasadorin zviceran

Një ditë pasi kishte kërkuar largimin e tij nga Kosova, ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka pritur në takim ambasadorin e Zvicrës, Jean Humbert Lebet. Lekaj ka thënë se në asnjë çast nuk ka kërkuar largimin e ambasadorit zviceran por, sipas tij, mediet e kanë nxjerrë nga konteksti deklaratën e tij. Ndërsa ambasadori Lebet ka thënë se çdo vërejtje që Zvicra bën, shteti i Kosovës duhet ta pranojë si një vërejtje nga një shtet mik



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 29 MARS - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, është sqaruar të premten me ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jean Humbert Lebet, rreth deklaratës së tij për largimin nga Kosova të diplomatit zviceran. Nëpërmjet një komunikate për medie, MIT-ja ka sqaruar se deklarata e ministrit Lekaj për diplomatin e huaj është nxjerrë nga konteksti nga mediet e shkruara. "Lekaj në asnjë çast nuk ka kërkuar largim të ambasadorit të Zvicrës në Kosovë, aq më tepër të kundërshtojë një shtet mik për Kosovën. Në deklarimin e tij, Lekaj ka theksuar se do të duhej një letër sqaruese për akuzat se veteranët në Kosovë janë të rrejshëm, për çka institucionet e drejtësisë ende nuk kanë dhënë një vendim", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit. Sipas komunikatës, Lekaj ka ripërsëritur falënderimin e tij dhe të shtetit të Kosovës për ndihmën e vazhdueshme të Zvicrës. "Ambasadori zviceran Lebet ka theksuar se çmon lart sakrificën e veteranëve të Republikës së Kosovës në luftën për liri dhe se çdo vërejtje që Zvicra dërgon, shteti i Kosovës duhet ta pranojë si një vërejtje nga një shtet shumë mik i kosovarëve. Ai shprehu keqardhje për të gjitha keqkuptimet që kanë ndodhur që nga dita e deklarimit të tij për veteranët dhe theksoi se miqësia Kosovë - Zvicër është e fuqishme, ndërsa ai personalisht ka admirim të veçantë për Kosovën", ka përfunduar komunikata.

Një ditë me parë ministri Lekaj në një emision televiziv kishte kritikuar ambasadorin zviceran, i cili, gjatë përurimit të një ujësjellësi, donacion zviceran në Skenderaj, kishte thënë se nuk është mirë që Kosova të paguajë veteranë të rrejshëm, kurse të tjerët të investojnë në projekte qenësore për qytetarët. "Nuk është çështje e ambasadorit për t'u marrë me ato. Është e pakuptimtë që para qytetarëve me e lidhë një investim me një temë të ndjeshme, me veteranët e luftës. Sikur të isha ai që marrë vendime, sot ia kisha dërguar letrën e largimit", kishte thënë ministri Lekaj.

Kjo deklaratë e ministrit Lekaj kishte nxitur reagime të shumta vendore edhe të ambasadorëve të akredituar në Kosovë. Ambasadori i Britanisë në Kosovë, Ruairi O'Connelli, ka qenë i pari diplomat perëndimor që i ka dalë në mbështetje ambasadorit zviceran, Jean Humbert Lebet. "Ambasadori zviceran e tha atë që ne të gjithë e mendojmë. Është koha që populli i cili e do Kosovën të veprojë kundër krimit dhe korrupsionit. Është një sfidë e vështirë dhe jo vetëm për Kosovën. Por, ata që veprojnë, do ta kenë përkrahjen tonë", ka shkruar O'Connelli në profilin e vet në "Facebook".

Më pas diplomati zviceran ka marrë mbështetje edhe nga ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt. "Kolegu im e ka thënë atë që e mendojnë të gjithë. Ne si komunitet ndërkombëtar jemi të angazhuar që të ndihmojmë. Gjermania dhe Zvicra e kanë mbështetur Kosovën me dhjetëra miliona euro për rregullimin e ujit dhe ujërave të zeza që nga viti 1999", ka shkruar Heldt në llogarinë e vet në "Twitter".

Për deklaratën e ministrit Lekaj ka pasur reagime edhe nga spektri politik vendor.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka kërkuar shkarkimin e ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, pasi ky i fundit bëri thirrje për largimin e ambasadorit zviceran Jean-Hubert Lebet. Ndërsa Blerim Latifi, këshilltar i kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se disa prej zyrtarëve të AAK-së, të cilët i quan miq, ka filluar t'i "tranojë" pushteti. "Një tjetër thotë se po të ishte në dorën e tij, sot do ta dëbonte nga Kosova ambasadorin e Zvicrës, që do të thotë se kemi ardhur deri aty sa edhe mikun, që ta thotë të vërtetën, me shpallë armik të shtetit", ka shkruar Latifi në profilin e vet në "Facebook", duke e ftuar kryeministrin që t'ua tërheqë vërejtjen zyrtarëve të vet.

# SBAShK-u: Nuk ka kompensim të orëve as në pushimin pranveror



PRISHTINË, 29 MARS (ER) - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBAShK) ka bërë me dije se Këshilli Drejtues i këtij institucioni ka vendosur që orët e humbura në grevë të mos kompensohen as në pushimin pranveror. Kështu është bërë me dije në komunikatën e këtij institucioni, i cili i ka uruar nxënësit për pushimin pranveror. "SBAShK-u, duke i uruar nxënësit për përfundimin e periudhës së dytë mësimore, iu dëshiron atyre dhe prindërve çaste të bukura të pushimit, me urimin që nxënësit dhe mësimdhënësit më 8 prill t'i rinisin angazhimet në betejat për dituri të reja", është thënë në komunikatën e SBAShK-ut.

SBAShK-u ka theksuar se ky vit ka qenë sfidues për këtë sindikatë dhe mësimdhënësit në përpjekje për t'i realizuar kërkesat e tyre të drejta. "Ju përgëzojmë për unitetin e treguar, sepse pas grevës kishte edhe tentime që me dezinformata e shpifje të dëmtohej uniteti i SBAShK-ut, por ju treguat vetëdije të lartë dhe ruajtët unitetin dhe figurën e respektuar të mësimdhënësit e sindikalistit", është thënë në këtë komunikatë.

SBAShK-u u ka bërë thirrje kryetarëve të komunave, drejtorëve të drejtorive arsimore dhe drejtorëve të shkollave, që të heqin dorë përfundimisht edhe në këtë pushim pranveror nga presionet ndaj mësimdhënësve. "Nuk do të bëni ftesa që mësimdhënësit pa asnjë arsye të paraqiten në vendin e tyre të punës, sepse ne këtë e konsiderojmë hakmarrje ndaj punëtorëve tuaj", është theksuar në komunikatën e SBAShK-ut.

Flet për "Epokën e re", Dhurata Hoxha

# Kosova e meriton lib



## - Presim deklarimin e Këshillit të Ministrave për liberalizimin e vizave

**Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se votimi i Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën është argument i rikonfirmimit të përpushjes së kritereve. Ajo ka thënë se tani vendimi për liberalizimin e vizave gjendet në duart e vendeve anëtare të Këshillit të Ministrave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxha ka deklaruar se pret nga Këshilli i Ministrave të deklarohet pro liberalizimit pas zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Ajo ka theksuar se vendimi për heqjen e vizave mund të merret në takimin e radhës, në rast se do të ekzistojë klimë pozitive e vendeve veç e veç për këtë çështje. Ministrja Hoxha ka thënë se deri atëherë do të punohet me vendet hezituese për t'i bindur me të arriturat e Kosovës**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 29 MARS - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka deklaruar se votim i së enjtes i Parlamentit Evropian është pjesë e procedurës për ta vazhduar mandatin e vendimit të mëparshëm për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se ky votim është argument i rikonfirmimit se Kosova ka përmbushur kriteret. "Nga institucionet evropiane, në veçanti nga Këshilli i Ministrave kemi kërkuar që në mbledhjen e dhjetorit të vlerësojnë punën tonë. Të mos na falin asgjë, por të këtë vlerësim të drejtë. Neve na janë vënë 95 kushte, dyfish më shumë se disa vendeve të tjera. Megjithatë, të gjitha një për një i kemi plotësuar. Pra, e kemi merituar liberalizimin. Ne nuk kemi kërkuar tjetër pos që kemi kërkuar trajtim të barabartë me shtetet të cilat deri më tash e kanë arritur liberalizimin. Përjashtimi ynë nga vlera elementare e BE-së është shumë i padrejtë", është shprehur Hoxha, duke shtuar se tani vendimi për liberalizimin e vizave gjendet në duart e vendeve anëtare të Këshillit të Ministrave.

Ministrja e Integrimit ka bërë me dije se pret nga Këshilli i Ministrave të deklarohet për liberalizim pas zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Në këtë kontekst, ajo ka vlerësuar se vendimi për heqjen e vizave mund të merret në takimin e radhës në rast se do të ekzistojë klimë pozitive e vendeve veç e veç për këtë çështje. "Pres që Këshilli i Ministrave të deklarohet për liberalizim, pas zgjedhjeve për Parlamentin Evropian që mbahen në maj. Pra, pres që kur do të dihet përbërja e re e parlamentit, të krijohet klimë e re brenda Këshillit të Ministrave për ta vendosur në rend dite, sepse nëse propozimi për shqyrtim të çështjes së liberalizimit nuk e disponon shumicën gjatë hartimit të vënies në rend dite, atëherë as nuk aprovohet. Nëse do të ekzistojë klimë pozitive e vendeve veç e veç për këtë çështje, atëherë edhe mund të realizohet, pra e gjitha varet nga vendet anëtare", ka theksuar ajo, duke shtuar se deri në mbajtjen e këtij takimi do të punohet me vendet hezituese për t'i bindur me të arriturat e Kosovës.

**"Epoka e re":** *Znj. Hoxha, Parlamenti Evropian (PE) të enjten ka votuar në favor të heqjes së regjimit të vizave për Kosovën. Si e komentoni këtë veprim dhe çfarë do të thotë ky votim për Kosovën?*

**Hoxha:** E enjtja ishte ditë kur shumica e eurodeputetëve, 331 nga 469 të pranishëm në Parlamentin Evropian, votuan pro liberalizimit. Është argument i rikonfirmimit të punës së institucioneve tona për kriteret e përmbushura që para një viti. Ky votim është pjesë e procedurës për ta vazhduar mandatin e vendimit të mëparshëm për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Ishte raport i raportueses Tanja Fajon ngaqë mandati i këtij procesi duhet të vazhdojë edhe në kohën e tranzicionit, pasi zgjedhjet për Parlamentin Evropian do të mbahen në muajin maj. Ne nga institucionet evropiane, në veçanti nga Këshilli i Ministrave, kemi kërkuar që për mbledhjen e dhjetorit ta vlerësojnë punën tonë. Të mos na falin asgjë, por të këtë vlerësim të drejtë. Neve na janë vënë 95 kushte, dyfish më shumë se disa vendeve të tjera. Megjithatë, të gjitha një për një

# eralizimin e vizave



i kemi plotësuar. Pra, e kemi merituar liberalizimin. Ne nuk kemi kërkuar tjetër pos që kemi kërkuar trajtim të barabartë me shtetet të cilat deri më tash e kanë arritur liberalizimin. Përjashtimi ynë nga vlera elementare e BE-së është shumë i padrejtë.

**"Epoka e re":** *Pas këtij votimi PE-ja dhe raportuesja e vizave për Kosovën, Tanja Fajon, kanë inkurajuar Këshillin Evropian që të veprojë. Në fakt, a prisni që Këshilli i Ministrave të BE-së në takimin e radhës të marrë vendim pozitiv për Kosovën dhe këtë vit të ndodhë liberalizimi?*
**Hoxha:** Po, çështja e liberalizimit mbetet çështje e hapur ende, por me konfirmim se të gjitha kushtet nga udhërrëfyesi janë kryer, pra rikonfirmohet nga instancat e deritashme se tashmë vendimi sërish gjendet në duart e vendeve anëtare të Këshillit të Ministrave. E shohim si vendim politik i lidhur me situatën e brendshme politike të vendeve të caktuara si dhe zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Pres që Këshilli i Ministrave të deklarohet për liberalizim, pas zgjedhjeve për Parlamentin Evropian që mbahen në maj. Pra, pres që kur do të dihet përbërja e re e parlamentit, të krijohet klimë e re brenda Këshillit të Ministrave për ta vendosur në rend dite sepse, nëse propozimi për shqyrtim të çështjes së liberalizimit nuk e disponon shumicën gjatë hartimit të vënies në rend dite, atëherë as nuk aprovohet. Nëse do të ekzistojë klimë pozitive e vendeve veç e veç për këtë çështje, atëherë edhe mund të realizohet, pra e gjitha varet nga vendet anëtare.

**"Epoka e re":** *Tani fokusi i shtetit të Kosovës duhet të mbetet te puna individuale me shtetet anëtare. Çfarë do të bëni në këtë drejtim për të pasur sukses?*
**Hoxha:** Njohja e shteteve hezituese me të arriturat tona është prioritet. Por, kur themi hezituese, nuk ka të bëj me qasjen e atyre vendeve ndaj pavarësisë tonë, sepse disa vende që kanë dhënë argumente të duken hezituese, janë njëkohësisht përkrahëset më të fuqishme të pavarësisë sonë. Çështja e hezitimit të tyre ndaj liberalizimit nuk ka qenë e lidhur me punën tonë sepse puna jonë ishte e dukshme se është kryer, por ishte e lidhur me çështjet e brendshme të tyre, zgjedhjet e brendshme në ato vende apo rritje e disponimit kundër emigracionit brenda atyre vendeve. Zbatimi i MSA-së, agjenda e reformave evropiane, reformat ekonomike, fuqizimi i sundimit të ligjit, suksesi ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare është punë jona ditore, e matshme dhe e qasshme brenda dikastereve përgjegjëse.

**"Epoka e re":** *Në këtë drejtim a mund të paraqesë problem çështja e taksës dhe dialogu?*
**Hoxha:** Deri më tani në takime zyrtare dhe jozyrtare nuk kemi pasur sinjalizime të tilla ngaqë rruga jonë në proces ka qenë e lidhur ngushtë me udhërrëfyesin për liberalizim dhe kriteret e definuara qartë të realizuara nga Republika e Kosovës. Nuk ka pengesë shtesë ndaj Kosovës për liberalizim. Nuk ka probleme të reja në këtë drejtim, por duhet vështruar realisht. Kosova, vendi i vetëm në Evropë me kufizim në lëvizjen e lirë, është vërtet frustruese. Kontributi i secilit vend me vlerat e veta përbën tërësinë për të cilën zotohet secili shtet sovran, me vullnet të bëhet pjesë e vlerave të përbashkëta evropiane. Që Kosova ka pengesa, është realitet i hidhur. Ne e dimë kontributin e secilit vend që Kosova të arrijë deri këtu. Ne jemi mirënjohës, por edhe ne me vlerat integruese duhet të jemi pjesë e motos së bashkuar me diversitet.

**"Epoka e re":** *Ministre, më 1 prill bëhen tri vjet prej që ka hyrë në fuqi Marrëveshja për Stabilizim Asocim (MSA). Sa ka arritur të zbatohet kjo marrëveshje dhe cilat janë sfidat kryesore të këtij procesi?*
**Hoxha:** Marrëdhënia e parë kontraktuale, Kosovë - BE, është MSA-ja. Është marrëveshje ndërkombëtare, prandaj mund ta vlerësojmë nivelin e zbatimit të Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) gjatë këtyre tri vjetëve. Sipas nivelit të zbatimit të PKZMSA-së, gjatë këtyre tri vjetëve është si vijon: viti 2016 - 55.46 për qind ose 762 nga 1 374 masa afatshkurtra të planifikuara; viti 2017 - 62.05 për qind ose 600 nga 967 masa afatshkurtra të planifikuara si dhe gjatë vitit 2018: 68.23 për qind ose 363 nga 532 masa afatshkurtra të planifikuara. Për këto tri vjet janë nënshkruar dhe janë në fuqi mbi 131 marrëveshje ndërkombëtare, kemi rritje të eksportit të produkteve kosovare në BE, të investimeve të huaja, rritje të vëllimit të të hyrave tatimore, rritje të numrit të bizneseve të reja, përparim në rritjen e klimës së të bërit biznes, anëtarësim dhe qasje në programet e BE-së si COSME, Erasmus +, Evropa kreative dhe Evropa për qytetarët.

## Veseli: Kosova do të jetë qendër e inovacionit në Ballkan

**Prizren, 29 mars (ER)** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar nga ministri për Inovacion dhe Ndërmarrësi, Besim Beqaj, ka vizituar të premten Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren, ku pritet të vendosen qindra inovatorë të rinj për t'i realizuar idetë e tyre kreative që do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe hapjen e vendeve të reja të punës për rininë e Kosovës.
Në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve kryeparlamentari Veseli dhe ministri Beqaj janë njoftuar nga menaxheri i Parkut, Wolfgang Leidig, për mundësitë që ofron hapësira prej 40 hektarësh të cilën e ka lënë si donacion KFOR-i gjerman e që kapë vlerën e investimeve 40 milionë euro. Me këtë rast, Veseli ka thënë se me këto kushte që i ofron tani vendi ynë për talentët e rinj, Kosova do të jetë qendër e Inovacionit në Ballkan. Ai ka thënë se kjo qendër është një mundësi dhe një mrekulli për Kosovën. "Me krijimin e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë kemi bërë një nga veprimet më të mençura. Ky është drejtimi që i duhet Kosovës. Në këtë ambient do të ketë vetëm inovatorë dhe ndërmarrës të rinj, të cilët do t'i japin shtysë transformimit dhe zhvillimit të Kosovës. Me këtë mundësi që na e ka krijuar shteti gjerman, ne jemi kampionë në Ballkan me ofertën për investitorë të huaj potencialë. Kjo qendër ofron mundësi të jashtëzakonshme", ka theksuar Veseli.
Ndërsa ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, e ka konsideruar parkun hapësirë të shumë të dobishme për vendin, me shumë pajisje dhe me një vlerë të madhe financiare, mbi 40 milionë euro, që KFOR-i dhe qeveria gjermane e ka lënë. "Ne ishim këtu së bashku me kryetarin Veseli për të parë se çfarë veprimesh do të ndërmarrim si Qeveri dhe si Kuvend, për ta funksionalizuar këtë Park. Ideja është që Parku të bëhet Qendër e Trajnimeve dhe e Inovacionit, e fokusuar në teknologjinë informative, në përpunimin e produkteve bujqësore, në turizëm", ka thënë Beqaj.
Në anën tjetër, menaxheri i Parkut të Inovacionit, Wolfgang Leidig, drejtor i njësisë implementuese, ka thënë se në mes të këtij viti do ta vazhdojnë thirrjen e bizneseve me qëllim të vendosjes së tyre në park.



## Policia konfiskon rreth 16 kilogramë marijuanë në kufi me Shqipërinë

Prishtinë, 29 mars (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se gjatë kontrolleve në zonën kufitare me Shqipërinë, njësiti antidrogë ka konfiskuar rreth 16 kilogramë të substancës narkotike, marijuanë. "Më 28. 3. 2019, në orën 11:00, në Pikën e Kalimit Kufitar Vërmicë, gjatë realizimit të detyrave zyrtare të zyrtarëve policorë dhe zyrtarëve të Doganës së Kosovës, një veturë me targa të Republikës së Shqipërisë është caktuar për kontroll në 'vijën e dytë'. Gjatë realizimit të kontrollit të detajuar të veturës është vërejtur se ka dysheme të dyfishtë. Pas hapjes së hapësirës është vërejtur se aty është fshehur substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë. Për rastin është njoftuar Njësiti i Antidrogës së Prizrenit, i cili ka sekuestruar gjashtëmbëdhjetë paketime të mbështjella, me peshë të përgjithshme 16 kilogramë e 954 gramë", është thënë në komunikatën e Policisë së Kosovës. Lidhur me rastin janë arrestuar dy të dyshuar meshkuj, shtetas të Republikës së Shqipërisë, kurse si provë materiale është konfiskuar një veturë dhe dy telefona celularë. Me aktvendim të prokurorit kompetent, të dyshuarit janë dërguar në mbajtje për 48 orë.



# Ministri Gashi: Kosova në mesin e vendeve të tjera në Bienale, shtet shumë i respektuar

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 MARS - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka marrë pjesë të premten në konferencën e parë zyrtare për medie me rastin e pjesëmarrjes së Republikës së Kosovës në Bienalen e Artit 2019 në Venedik. Në këtë konferencë u prezantua projekti i cili do ta përfaqësojë Kosovën në ekspozitën e 58 të Bienales së Venedikut.

Ministri Gashi u shpreh i lumtur me përzgjedhjen e Alban Mujës si një artist i dëshmuar brenda dhe jashtë vendit me projektet e tij. Ai, po ashtu, ka bërë me dije se pavijoni i Kosovës në vitin 2019 ka si komisionare Arta Aganin, drejtoreshë e Galerisë Kombëtare të Kosovës, e cila, bashkë me artistin Muja, kanë bërë përzgjedhjen e kuratorit Vincent Honore që, po ashtu, sipas ministrit Gashi, ka një përvojë të dëshmuar, si dhe të asistentes që do ta ndihmojë këtë organizim, Anya Harrison. "Ky eveniment rangohet si një prej organizimeve më të mëdha kulturore botërore dhe jam shumë i lumtur që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është rikthyer në këtë eveniment në dy vjetët e fundit, dhe tashmë jemi pjesë e kësaj ngjarjeje", ka thënë Gashi, duke shtuar se artistët tanë po e promovojnë Kosovën më së miri. "Janë pikërisht artistët ata të cilët po e bëjnë punën edhe të sektorëve të tjerë të cilët janë kompetentë për promovimin e shtetit, siç janë ambasadat dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Jam shumë i lumtur që tashmë e kemi targetuar një sektor siç është kultura dhe një komunitet siç janë artistët, ata të cilët po e përfaqësojnë Kosovën gjithandej botës", ka thënë ministri Gashi.




Ai ka theksuar se prania e tij në këtë konferencë është për ta konfirmuar edhe një herë mbështetjen e Ministrisë dhe të Qeverisë së Kosovës për këtë ngjarje. Ministri Gashi ka thënë se ndihet i lumtur që Kosova në mesin e vendeve që janë pjesë e Bienales është shtet shumë i respektuar. "Besoj se Kosova, ashtu sikurse vitin e kaluar, do të jetë një prej pavijoneve më të vizituara duke pasur parasysh edhe temën që artisti e ka përzgjedhur, një temë shumë interesante që pasqyron përjetimet e tij personale dhe ato kolektive të popullit të Kosovës gjatë luftës në Kosovë", ka thënë Gashi.

Ndërkaq artisti Alban Muja fillimisht ka përshëndetur ministrin Gashi për përkrahjen e këtij projekti dhe komisionaren Agani për bashkëpunim, gjithashtu edhe kuratorët që, siç ka thënë ai, kanë ndihmuar në zhvillimin e projektit në një dimension tjetër. "Bienalja e Venedikut është një prej evenimenteve më të rëndësishme të artit në përgjithësi dhe nominimi na ka bërë të ndihemi jo vetëm krenarë, por edhe përgjegjës. Me të gjithë ekipin po përpiqemi të bëjmë një punë për përfaqësim të vendit sa më dinjitoz", ka thënë Muja.

## Arkitektja Eliza Hoxha i bashkohet PDK-së

PRISHTINË, 29 MARS (ER) - Arkitektja dhe artistja Eliza Hoxha ka vendosur të inkuadrohet në politikë, duke iu bashkuar Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Lajmin e ka bërë me dije të premten lideri i PDK-së, Kadri Veseli, i cili ka postuar në faqen e vet në "Facebook" edhe fotografi nga aderimi i saj. "Mirë se erdhe në PDK, Eliza! Profesionalizimi dhe dashuria jote për Prishtinën janë vlerë e madhe në Dekadën e Re, ndërsa PDK-ja mbetet hapësira më e mirë për secilin që ka vizion, plan dhe dëshirë për ta ndryshuar vendin. Me ty dhe të tjerët, Dega e PDK-së në Prishtinë i jep kryeqytetit atë që po i mungon prej kohësh: vullnetin për t'ia zgjidhur problemet", ka shkruar Veseli.

PDK-ja aktualisht është duke zhvilluar procesin e brendshëm zgjedhor dhe siç duket nga ky postim i Veselit, Eliza Hoxha do të jetë e angazhuar në Degën e PDK-së në Prishtinë. Eliza Hoxha, e cila ligjëron në Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës, është emër i njohur edhe në fushën e artit, ndërsa paraqitjet e saj në debatet për zhvillimin e Prishtinës kanë qenë të shpeshta.



# Krasniqi: Kjo KQZ do t;i rrënojë zgjedhjet e lira dhe demokracinë

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë të premten se kjo përbërje e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) do t'i rrënojë zgjedhjet e lira dhe demokracinë. Ai ka thënë se kështu siç është konstituuar KQZ-ja, nuk mund të konsiderohet si institucion për mirëvajtje, por institucion për tallavajtje



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 29 mars** - Kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka shkruar një shkrim në llogarinë e vet në "Facebook" me titull "Kjo KQZ do t'i rrënojë zgjedhjet e lira dhe demokracinë. Krasniqi në këtë shkrim ka theksuar se me këtë konstituim të KQZ-së, në rend të parë, është shkelur rend neni 139, paragrafi katër i Kushtetutës, për ndërtimin e një institucionit të pavarur, i cili e ka përgjegjësinë për ta mbikëqyrur mirëvajtjen e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. "Ndërsa kështu siç është konstituuar, nuk mund të konsiderohet si institucion për mirëvajtje, por institucion për tallavajtje", ka shkruar Krasniqi. Ai ka thënë se Kushtetuta e thotë qartë, se KQZ-ja përbëhet nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare të Kuvendit. "Pasi vetëm kjo përbërje që e ka nënvizuar Kushtetuta, garanton zgjedhje të lira, të drejta dhe demokratike, gjë që nuk e garanton përbërja, si po tentohet të konstituohet KQZ-ja", ka thënë ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi.

Veç kësaj, ai ka pohuar se kjo mënyrë e konstituimit është kapje e KQZ-së nga partizanët e zëshëm të kapjes e të shkapjes së institucioneve të shtetit. "Për partizanët e shkapjes, që brenda natës u bënë kapës të një institucioni të pavarur, kush mund të na garantojë që nesër nuk do të dakordohen këta partizanë të vegjël për kapjet e tjera si, p. sh., edhe të krimit e të korrupsionit?! Praktika jetësore na tregon: Kushdo që ka vjedhur a ka grabitur pak, sa herë iu ka dhënë mundësia, ka vjedhur e grabitur edhe shumë. Ata që e kapen KQZ-në, vështirë është për t'iu besuar se, nëse vijnë në pushtet, nuk do t'i kapin edhe institucionet e tjera dhe do të bëhen pronarë të kapjeve të tjera. Përndryshe, pse të bëheshin kapës të KQZ-së së bashku me atë që e kanë akuzuar bash për çdo gjë?", ka thënë Krasniqi.

Ai ka theksuar se me këtë logjikë veprimi, degradimi i demokracisë, por edhe i shtetndërtimit, do të vazhdojë të thellohet. "Të përfundoj: Kërkoj nga të gjithë ata që e udhëzuan, që e kërkuan dhe e realizuan këtë kapje të KQZ-së, e cila kapje do t'i dëmtojë rënd zgjedhjet e lira dhe demokratike dhe vetë demokracinë, mos të na dërdëllisin më, për mungesë demokracie a mungesë vullneti për ta luftuar krimin e korrupsionin si dhe mossundim të ligjit në Kosovë?! Ata duhet që ta dinë se këtyre shëmtive të përmendura dhe shumë të tjerave të papërmendura ua trasuan të gjitha rrugët ekzistuese, duke hapur edhe të reja! Me këtë logjikë veprimi, degradimi i demokracisë, por edhe i shtetndërtimit, do të vazhdojë të thellohet! Qofsha i gabuar!", ka thënë Krasniqi.

Pas dymbëdhjetë muajve bllokadë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka arritur të bëhet funksional. Zhbllokimi i KQZ-së është bërë të enjten nga presidenti Hashim Thaçi, me emërimin e tetë anëtarëve të rinj. Megjithatë, ky institucion ende nuk është kompletuar tërësisht, meqenëse mungojnë dy përfaqësuesit e koalicionit PAN. Sidoqoftë, pas emërimit të anëtarëve të rinj, KQZ-ja ka mbajtur mbledhjen e parë në të cilën është marrë vendimi për zëvendësimin e deputetit të Kuvendit të Kosovës, Nezir Çoçaj me Rafet Ramën, si dhe është marrë vendimi për zëvendësimin e këshilltarëve nëpër kuvendet komunale.

# PSD-ja kërkon përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në nivelet vendimmarrëse

**Prishtinë, 29 mars (ER)** - Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), njëherësh kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, dhe anëtarja e kryesisë, Teutë Rrusta, kanë prezantuar agjendën e kësaj partie për barazi gjinore si brenda subjektit, po ashtu edhe nëpërmjet modelit të tyre qeverisës.

Në një konferencë për medie, Kastrati ka treguar se në Komunën e Kamenicës tashmë 54 për qind e drejtorive udhëhiqen nga gratë, ndërsa në Komunën e Prishtinës 44 për qind. Ndërsa Teutë Rrusta u ka bërë thirrje grave dhe vajzave, me bindje socialdemokrate, të bashkohen në agjendën e tyre për barazi gjinore.

Ata kanë bërë me dije se Këshilli Drejtues i Partisë Socialdemokrate, pas dy mbledhjeve më 8 dhe 28 mars 2019, që për diskutim kishin format e organizimit të brendshëm që reflektojnë edhe parimet mbi të cilat vepron si subjekt, vendimin e parë që ka marrë që nga rifunksionalizimi i partisë, ka të bëjë me përfaqësimin e barabartë të grave dhe të burrave në të gjitha nivelet vendimmarrëse, 50-50.



## Data e fundit për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, 1 prilli

**Prishtinë, 29 mars (ER)** - Agjencia Kundër Korrupsionit ka njoftuar të gjithë zyrtarët e lartë publikë, të cilët nuk e kanë deklaruar pasurinë, se detyrimin e tyre ligjor duhet ta kryejnë deri të hënën, më 1 prill. "Llogaritja e këtij afati është bërë në përputhje me paragrafin 4, Nenin 81, të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: 'Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk do ta pengojnë fillimin dhe ecjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie të shtunën, të dielën apo një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen menjëherë pas saj'", është thënë në njoftimin e AKK-së.

Agjencia është në dispozicion të të gjithë zyrtarëve në mënyrë që procesi i deklarimit të rregullt të pasurisë të kryhet me sukses.



# Nostalgjikët e taksës, dashamirët e keksit dhe viktimat e seksit!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

**Nostalgjikët e taksës:** Askush, madje as ne analistët që jemi shtuar si shtogu afër m...t, nuk e kemi paraparë se taksa prej 100 përqindësh për mallrat nga Serbia dhe Bosnja, do të ketë jetë aq të gjatë. Edhe ata që e pranuan atësinë dhe mëmësinë për këtë taksë, pa pasur nevojë ta bëjnë ADN-në, pas një kohe u lodhën duke deklaruar se duhet të pezullohet për katër (4) muaj e pastaj, nëse Serbia nuk mbledh mend, mund dhe duhet të rikthehet. Për këtë e patën përkrahjen e atyre që vranë e kthjellin në Kosovë e që ne i quajmë miq ndërkombëtarë duke u përbetuar për nënshtrim të përjetshëm. Te ne, sidomos te një pjesë e atyre që ua merr mendja se merren me politikë, me të ardhur në pushtet, që në fillim i lëshojnë brekushet para këtyre miqve duke mos e bërë dallimin midis mirënjohjes, falënderimit dhe nënshtrimit! Ka të tillë që thonë se: "Pa më thënë Amerika, as me grua nuk flejë..." dhe gënjejnë, pa asnjë dyshim. Amerikën e përdorin si mbulesë për ta maskuar impotencën seksuale sepse nuk kanë guxim ta përdorin "hajmalinë" e Ferid Muratit e që e quajnë viagra. Ma merr mendja se miku i vërtetë nuk e donë mikun që i nënshtrohet, të gjunjëzuar, pa dinjitet, pa koqe apo me koqe që përmbajtjen e kanë si të trileqesë! Nuk besoj se midis dy shteteve ka miqësi të përjetshme për faktin se politika është interes i dyanshëm, midis dy shteteve normale apo bindje dhe nënshtrim, midis dy shteteve, njëri prej të cilëve nënshtrohet që më parë. I keni parë disa ambasadorë, me një dorë ta jep shishen me ujë, me tjetrën të kapë për fyti! Kjo është kur e ke të falur dhe jo të fituar me djersë. Po besoj se Kosova është shtet i dinjitetshëm që e ka dëshmuar me faktin se niveli i korrupsionit tregon rezultate për admirim për faktin se gjithmonë jemi në majat e listave ndërkombëtare. Sa i përket qëndrimit në krye të listave, jemi më të fortë se Reali dhe Barcelona bashkë. Ndërkaq, sa i përket nepotizmit (punësimit të të afërmve të ngushtë dhe të gjerë) mendoj se është ekzagjeruar për faktin se njoh shumë fëmijë të njerëzve me pushtet që janë në çerdhe dhe shkolla private dhe ende nuk e kanë një vend pune. Apo, që në moshën e adoleshencës kanë realizuar ndonjë tender simbolik, sa për para të xhepit, me një shumë gjithashtu simbolike prej 300-400 000 euro. Kosova, pas vendosjes së taksës, e sidomos pas refuzimit të pezullimit të kësaj takse, u faktorizua në planin ndërkombëtar duke e forcuar pozitën negociuese. Tash mund të themi ç'të duam dhe varësisht nga interesi që na udhëheq mirëpo, po të mos ishte kjo taksë, Hashimi dhe Aca do t'i prisnin biletat për Uashington ku, në prani të presidentit Tramp dhe "mikut" të madh të Kosovës, Xhon Bolton, do ta nënshkruanin një marrëveshje për integrimin e Lemes nga Medvegja në Kosovë si dhe disa këshilltarëve politikë nga Lugina e që në Kosovë janë integruar pasi janë martuar këtu dhe kanë zënë një vend pune, Luginën e Preshevës e përdorin si "Vaj e mall për Çamërinë". Taksa për mallrat nga Serbia dhe Bosnja ka pamundësuar nominimet për Çmimin Nobel për Paqe për maskarenjtë e Brukselit, Mogerinin dhe Hanin, politikanët që pretendonin se janë e ardhmja e që, sipas të gjitha gjasave, po bëhen pjesë e së kaluarës, pa mundësi riciklimi, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiqi dhe presidenti Tramp i cili, po të arrihej një marrëveshje, do ta fitonte Çmimi Nobel për Ekonomi dhe Letërsi. Kohët e fundit për taksën nuk po flasin as militantët për pezullimin e saj; Bororamiz Kelmendi, Enveri nga Gjiroreka, Xhaviti M16, tovarish Pacolli, as biseksualët politikë të LDK-së e as Nisma që kohën e fundit u zbythë për taksën por, flamurin e mosdorëzimit për pezullim të taksës, po e mban heroikisht dhe stoikisht vetëm Hajdari nga Gjylekari. Me fjalë të tjera, nëse Ramushi nuk ka bërë asgjë tjetër, e unë them se ka bërë shumë, vetëm këmbëngulja për mbajtje të taksës e arsyeton. Po ta takosh ambasadorin Kosnet në rrugë, duhet të largoheni për faktin se duket si buldozer e lëre më t'ju hyjë në zyrë dhe, "me fjalë të ëmbla" "tu lutë" ta pezulloni taksën. Apo kur duhet t'i rezistoni tundimit për ta refuzuar kërkesën e së "Bukurës së nëntokës", Federika Mogerinit apo "bredhësit mashtrues", Johanes Han. Por, përfundimisht, së paku, deri më tani mbajtja e taksës 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja po del të jetë mbrojtësi më i mirë dhe më efikas i kufijve të Kosovës se vet KFOR-i, ndonëse politikisht i ka kaluar afati i përdorimit.

**Dashamirët e keksit, zgjedhjeve të parakohshme:** Dy subjekte politike, LDK-ja dhe LV-ja, që nga certifikimi i rezultatit të zgjedhjeve të fundit, tërë aktivitetin politik e bënin për zgjedhje të parakohshme. LDK-ja është e sigurt se i fiton zgjedhjet, ndonëse ka shumë probleme me udhëheqje; nuk dihet kush është kryetar dhe ka shumë të interesuar për t'u bërë kryetar! Vlerësimi im është se LDK-ja i fiton zgjedhjet, me një dallim të papërfillshëm ndaj subjektit që do të renditet i dyti e ai subjekt është LV-ja dhe me të cilin ka shfaqur gatishmëri të krijojë marrëdhënie martesore politike apo bashkëjetesë pushtetare. LDK-ja, nëse zgjedhjet mbahen deri në qershor të këtij viti e që unë nuk besoj, madje jam i sigurt se nuk do të ketë zgjedhje në këtë kohë, do të fitojë por se, për formimin e qeverisë, më së paku do të vendosë LDK-ja për faktin se do të shantazhohet nga të gjithë. Sot LDK-ja problemin më të madh e ka se kush do të bëhet kryetar dhe se lufta më e madhe po bëhet nën rrogoz për "mbretin" e ardhshëm të LDK-së. Aktualisht në LDK nuk ka politikan që do të pranohej nga shumica e anëtarësisë së kësaj partie dhe nuk ka asnjë kandidat që e ka një karizmë, të nevojshme apo të domosdoshme për një lider politik që e kërkojnë standardet ballkanike. Për lider të profilit evropian as që mund të flitet. Prandaj, mendoj se Isa Mustafa mund të kandidohet edhe për një mandat apo që Kuvendi Zgjedhor i kësaj partie të shtyhet për më vonë! Sa më shumë të shtyhen zgjedhjet, votat për LDK-në do të ulen. LV-ja po kërkon gjithashtu zgjedhje të parakohshme, me shpresë se do të dalë partia fituese, për çka dyshoj. LV-ja, pa pjesën e shkëputur të saj, e ka të vështirë të arrijë rezultatet e fundit, ndonëse strategët e kësaj partie, sipas meje, e kanë shumë gabim, mendojnë se, duke e luftuar PSD-në, do ta rrisin numrin e votave. LV-ja ka arritur majat e Himalajave politike në zgjedhjet e fundit dhe vetëm një koalicion parazgjedhor me LDK-në, AAK-në, Nisma u garanton fitore por se, pastaj, lindin probleme se si të ndahet pitja. LV-ja nuk duhet ta përjashtojë nga koalicioni parazgjedhor ose pas zgjedhjeve as PSD-në e as PDK-në për faktin se nuk është më subjekti politik që sillen të gjithë rreth saj. Po të mbahen zgjedhjet deri në qershor, fituesi më i madh do të jetë AAK-ja kurse humbës më i madh, pa asnjë dyshim do të jetë PDK-ja. Nëse zgjedhjet do të mbahen në vjeshtën e vonshme do ta kishim një situatë tjetër; nëse PDK-ja arrin t'i pastrojë radhët nga përfituesit e luftës dhe të paqes dhe të përtërihet me kuadro të reja, do të ngritët lartë në tabelën politike. PDK-ja po e përdorë metodën kineze të politikës; sa më i moshuar të jeni, aq më shumë do të keni pushtet. Duket se ky vit do të jetë vit i zgjedhjeve në shtetet e BE-së, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Serbi dhe se do të vizatohet një konjukturë tjetër politike dhe qeverisëse. Por, mbetet ta shohim! Po thonë se Hashim Thaçi u dorëzua para amerikanëve për kompletimin e KQZ-së. Është e kundërta; Hashimi po e luan lojën që nuk po e kuptojnë të tjerët duke futur sherr midis subjekteve politike. Duke lënë jashtë KQZ-së PSD-në, Nismën, AAK-në e sidomos AKR-në, e nxiti hidhërimin e këtyre subjekteve politike dhe e bëri paqëtimin e LDK-së dhe LV-së. Tash, partitë kundërshtuese mund ta dërgojnë këtë lëndë në Gjykatën Kushtetuese dhe kjo Gjykatë mund ta marrë një vendim që përsëri paralizon KQZ-në. Në anën tjetër, pasi me PDK-në nuk pati mundësi ta rrëzojë qeverinë Haradinaj, tash me AAK-në, Nismën, PDK-në dhe sidomos me AKR-në mund ta rrëzojë qeverinë. Nuk ma kap mendja se si ka mundur ta lërë sidomos AKR-në pa asnjë përfaqësues në KQZ?! Gjithashtu, aspak nuk besoj se koalicioni PAN do të shkojë në zgjedhje për faktin se nuk janë të përfaqësuar në KQZ, sipas parimit të stupcit! Mirëpo, Hashimi po e luan lojën; mirë me amerikanë sa i përket KQZ-së, mirë me LDK-në dhe LV-në por se ka aktivizuar minën në pjesën e KQZ të pozitës. Kur ta kërkojë Hashim, fitilin në KQZ e ndezë Betimi!

**Viktimat e seksit:** "Rroku, rrokullisni gajdet, bëni qefin tamam, se qejfi është i ëmbël, nuk blihet o me para....". Kjo serenatë e mrekullueshme korçare e tregon një realitet të besueshëm derisa doli në skenë humanisti i madh Ferid Murati me zbulimin e tij që, krijon kushte që, me para mund të blihet edhe qefi(ni). Zbulimi i Ferid Muratit i përmbledh dy skajet; siguron kënaqësi për ata që po shkepojnë për arsye të ndryshme, objektive dhe subjektive por, në anën tjetër, e luan rolin e vrasësit masiv, sidomos për kategorinë e cenueshme e që kanë probleme shëndetësore, por që duan ta dëshmojnë të kundërtën. Numri i atyre që e kanë paguar taksën e dashurisë me ndihmën e viagras, në botë është bukur i madh sikur që është edhe në Kosovë. Në Kosovë, disa personalitete të shquara dhe të pashquara, falë Ferid Muratit kanë mbetur "mbi të". Rasti i fundit, nëse i referohemi medieve, ishte martiri 74-vjeçar që u "martirizua" për zanën 22 vjeçe.

Thuaja në të njëjtën kohë, deputetët e Kuvendit të Kosovës e luajtën një lojë të pornografisë politike dhe juridike duke mbyllur me një dekret të gjitha lojërat e fatit dhe kazinotë që papengueshëm kishin operuar që nga përfundimi i luftës në Kosovë. Si pretekst u përdorën vrasjet kriminale të dy të punësuarve në kazino që ishin duke punuar aty për një pagë. Pastaj, deputetët e Kuvendit të Kosovës, shumica e të cilëve i kapen ligjit pas bishtit apo për qëllime politike, kërkuan që të mbyllen të gjitha lojërat e fatit dhe kazinotë, ndonëse një numër i tyre ishin pajisur me leje pune, kishin paguar tatime dhe taksa të tjera dhe nuk kishin rënë në kundërshtim me kushtet e parapara me ligj. Dikush prej deputetëve u kujtua se edhe Lotaria e Kosovës duhet të mbyllet e që u pranua me aklamacion. Kohë më parë kishte të vrarë edhe gjatë grabitjes së bankave, pompave të karburanteve, shtëpive private apo objekteve tregtare. Asnjë nga këto objekte nuk u mbyll. Objektet biznesore mund të mbyllen vetëm me vendim të gjyqit nëse aty ushtrohet ndonjë aktivitet kriminal dhe kurrsesi me vendim politik apo për qëllime politike. Kjo i përngjanë një fushate sikur që bëhej konfiskimi apo shpronësimi i pronave, pas përfundimit të luftës në vitet 1945. Pse do të duhej të mbyllej Lotaria e Kosovës dhe si do të veprohet me asetet që i ka? Si do të veprohet me të punësuarit aty e që janë mbajtës të familjes apo edhe kanë kredi bankare dhe tash, pas mbylljes arbitrare, në pamundësi të paguajnë kreditë, duhet të përballen me përmbaruesit. Kush do të marrë përgjegjësinë për këtë veprim të Kuvendit të Kosovës? Në asnjë vend normal në botë nuk i merret askujt licenca e punës, me një vendim politik! Është i njohur parimi juridik se: "nuk mund të merret një drejtë e fituar nëse kjo nuk është objekt i veprës penale për të cilin duhet një vendim i gjykatës përkatëse...". Duket se prapa saj është një lojë më e madhe! Tash, kazinotë dhe bastoret do të kalojnë në ilegalitet të thellë me ç'rast shteti e humbë kontrollin mbi to, nuk i mbledhë taksat dhe tatimet kurse shkalla e kriminalitetit do të rritet. Është e pamoralshme që vrasja në kazino në komunën e Suharekës të ndërlidhet me militantizëm partiak sepse kjo vrasje, sipas dyshimeve të para nuk është bërë për të ndihmuar një subjekt të caktuar politik apo për të dëmtuar tjetrin por se prapavija është grabitja e parave dhe asgjë tjetër. Shteti është dashur me kohë të rregullojë dhe mbajë nën kontroll lojërat e fatit dhe kazinotë dhe vendimi i Kuvendit të Kosovës për mbyllje të përgjithshme është në kundërshtim të çdo logjike juridike, ligjit të punës dhe të drejtave të njeriut.

Po të vepronin sipas parimit moral dhe politik, deputetët e Kuvendit të Kosovës, pas vdekjeve të shpeshta nga viagra, do të miratonin një ligj për mbylljen e të gjitha barnatoreve ku shitet viagra dhe të gjitha moteleve apo hoteleve ku organizohen "seancat e pushimit" e që nuk e kanë bërë këtë. Në një shtet normal, politika nuk është mbi ligjin dhe vetëm me ligj vendoset rendi dhe rregulli. Kosovën, më shumë e kanë dëmtuar oligarkët plaçkitës, korrupsioni endemik, nepotizmi çoroditës, klientelizmi primitiv dhe politikanët vendorë dhe ndërkombëtarë që, qindra dhe miliarda euro të tenderëve dhe të privatizimit i kanë përvetësuar duke i investuar në parajsat fiskale dhe duke krijuar perspektivë derri në Kosovë!

## AKP-ja miraton listën e shitjes së 121 aseteve të ndërmarrjeve shoqërore

Prishtinë, 29 mars (ER) - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ka mbajtur mbledhjen e rregullt, në të cilën ka diskutuar dhe ka marrë vendime të rëndësishme për procesin e privatizimit dhe të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në përputhje me mandatin e vet ligjor.
Gjatë kësaj mbledhje menaxhmenti ka raportuar para Bordit të Drejtorëve për aktivitetet e agjencisë, ndërkaq është diskutuar edhe raporti vjetor i agjencisë, i cili është miratuar në mënyrë unanime. "Në këtë takim Bordi shqyrtoi dhe njëzëri miratoi listën e valës së shitjes së aseteve me likuidim nr. 47, valë kjo që përfshin 121 asete atraktive të ndërmarrjeve shoqërore në Republikën e Kosovës, të cilat paraqesin një mundësi të shkëlqyer për investitorët potencialë që kanë interesim për zgjerim të biznesit apo iniciativa të reja biznesore në vendin tonë. Bordi, me propozim të menaxhmentit, vendosi që depozitat për asetet që gjenden në zona rurale të ulen, në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrje në tender e sa më shumë të interesuarve dhe kështu të zhvillohet një konkurrencë më e madhe", është theksuar në komunikatën e AKP-së.
Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ka diskutuar edhe në lidhje me asetet specifike që janë nën administrimin e kësaj agjencie dhe ka aprovuar raportin e komisionit përkatës, me ç'rast ka dhënë pëlqimin për fillimin e procedurave të negocimit për disa asete specifike në disa rajone të Kosovës.
Gjatë kësaj mbledhje Bordi i Drejtorëve ka aprovuar edhe draftmarrëveshjen me Ministrinë e Administratës Publike për pagesën e shpronësimit me këste për ndërtesën e Bankës së Lubljanës, pastaj draftmarrëveshjen me këtë ministri dhe me Komunën e Prishtinës për pagesën e shpronësimit me këste për ndërtesën "Shtëpia e Re e Mallrave", për ndërmarrjen shoqërore "Gërmia", si dhe një pjesë të tokës së NSh "Slloga".



# Nisin punimet në Zonën Ekonomike në Vushtrri

Të premten kanë filluar punimet në Zonën Ekonomike në Lumadh të Vushtrrisë. Ky është një investim i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në vlerë prej 1.3 milion eurosh

EPOKA E RE A. MAVRAJ

VUSHTRRI, 29 MARS - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, bashkë me kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahrin, kanë përuruar të premten nisjen e punimeve në Zonën Ekonomike në Lumadh të Vushtrrisë, që është një investim i MTI-së në vlerë prej 1.3 milion eurosh.
Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala ka theksuar se po punohet për përmirësimin e infrastrukturës ligjore, duke bërë oferta konkrete për të sjellë kompani të mëdha që ta investojnë kapitalin e tyre në Kosovë. "Po ashtu, po krijojmë kushte fizike për bizneset vendore dhe ndërkombëtare në mënyrë që aktivitetet e tyre t'i kenë sa më të lehta dhe në kushte sa më të mira. Duke iu krijuar kushte përmes hapësirave të mjaftueshme fizike dhe lehtësirave konkrete, synojmë rritjen e prodhimit vendor, hapjen e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit", ka thënë ministri Shala.
Ministri Shala ka theksuar se ndërtim të zonave ekonomike do të ketë edhe në qytete të tjera të Kosovës, me qëllimin që të ofrimit të ndihmës bizneseve me hapësira fizike dhe qira të lirë. Ndërsa kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka theksuar se ky është investimi më i madh në Vushtrri, duke e konsideruar si mundësi të jashtëzakonshme për bizneset.



"Sot është lajm i gëzueshëm për Vushtrrinë sepse po ndodh investimi më i madh në vitet e fundit. Zona Ekonomike ka qenë një prej premtimeve tona kryesore dhe sot, me një bashkëpunim të MTI-së dhe KIESA-s, ne kemi filluar punën në zonën ekonomike. Jemi zotuar të tërheqim biznese që vijnë edhe nga diaspora që të krijojmë më shumë hapësirë dhe mbështetje për sektorin privat dhe të kemi zhvillim ekonomik", ka thënë Tahiri.

## KEDS-i hapi dyert për nxënësit

PRISHTINË, 29 MARS (ER) - KEDS-i ka hapur dyert për nxënësit që të mësojnë rreth energjisë elektrike, me theks të veçantë efiçiencën e energjisë elektrike. Në kuadër të këtij aktiviteti kompania priti rreth 100 nxënës nga Shkolla Fillore "Ganimete Tërbeshi" nga fshati Llukar dhe grupi tjetër nga Shkolla Fillore "Meto Bajraktari" nga Prishtina. Para nxënësve prezantimin e mbajtën studentët e KEDS Academy, të trajnuar për këtë lëmë, tash punonjës në KEDS.
Ligjërata nxënësve u është dukur tepër atraktive. Ata përveç kursimit të energjisë elektrike u informuan rreth KEDS-it dhe gjithçka që ka të bëjë me energjinë elektrike. Nxënësit e këtyre shkollave ishin mjaft të interesuar dhe shumë kureshtarë, sidomos për pajisjet elektrike, që në prezantim ishin personazhe me emra. Bunës, njëra nga nxënëset, përshtypje i kishte lënë personazhi i Bardhës (Rrobalarësja).
Nxënësit këshillat e marra këtu thanë se do t'ua tregojnë shokëve dhe shoqeve të tjera, por edhe prindërve në shtëpi. Surpriza më e madhe për nxënësit ishte njeriu i energjisë Elmeni, ku të gjithë të rrethuar pas tij u kënaqën duke kënduar. Të impresionuar mbetën edhe mësimdhënësit të cilët shoqëronin fëmijët.
Mësuesja Valdete Gjakova nga shkolla "Meto Bajraktari" ka thënë se ligjërata e sotme ishte në përputhje me lëndët mësimore që zhvillojmë në shkollë dhe shumë e kapshme për fëmijët. "Fëmijët u kënaqën sot dhe në emër të shkollës falënderoj KEDS-in për mikpritjen dhe organizimin profesional të paraqitur me një nivel të lartë që nuk e kemi parë më herët", ka thënë mësuesja Gjakova.
Ky projekt nuk mbaron këtu. KEDS-i do të vazhdojë t'i mbajë prezantimet në ndërtesën qendrore të kompanisë edhe për nxënës të shkollave të tjera të interesuara.



# Komuna e Drenasit kërkon nga barnatoret ta respektojnë orarin e punës

DRENAS, 29 MARS (ER) - Pas pranimit të disa kërkesave nga ana e bizneseve të barnatoreve në territorin e Komunës së Drenasit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka njoftuar të gjitha bizneset e barnatoreve, se orari i punës vazhdon të jetë sipas vendimit të 31 janarit të këtij viti të Kuvendit Komunal. Kjo komunë ka bërë me dije se drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, Egzona Jetullahi, ka mbajtur takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e barnatoreve që operojnë në territorin e Drenasit dhe i ka njoftuar se orari për kujdestari dhe orari i rregullt mbetet sipas marrëveshjes mes përfaqësuesit e barnatoreve. "Sipas vendimit të Kuvendit, i cili është publikuar edhe në uebfaqe zyrtare të komunës, orari i periudhës verore është nga ora 08:00-21:00, në periudhën dimërore nga ora 08:00-19:00, kurse në fundjavë (e diel) dhe gjatë festave zyrtare do të kujdestarohet 24 orë. Në raste urgjente mund të punohet edhe jashtë orarit të paraparë më lart. Të shtunave do të punohet nga ora 08:00 deri në orën 14:00", ka njoftuar Komuna e Drenasit.






# Nderohen dëshmorët dhe martirët e lirisë në Skenderaj

SKENDERAJ, 29 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, nënkryetari Nuredin Lushtaku, drejtorët komunalë, familjarë të të rënëve, si dhe bashkëluftëtarë të dëshmorëve, kanë bërë të premten homazhe te varri i dëshmorit Avdullah Kodra, në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë, në 20-vjetorin e rënies së tij.
Në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga Komuna e Skenderajt, për nder të 20-vjetorit të rënies së dëshmorëve të kombit, delegacioni i kësaj komune ka bërë homazhe edhe te lapidari në nderim të të rënëve në Klinë të Poshtme. Pas homazheve, kryetari Jashari ka theksuar se është obligim i tyre t'i nderojnë të gjithë dëshmorët dhe martirët që dhanë jetën e tyre për lirinë që sot gëzojmë. "Është obligimi ynë t'i nderojmë të gjithë ata që dhanë jetën, që ne të gëzojmë lirinë dhe pavarësinë e vendit. Kemi qëndruar bashkë në ditët më të vështira, pse mos të jemi bashkë edhe sot në ditë të mira. Lavdi heronjve dhe martirëve të Kosovës!", ka thënë kryetari Jashari.




# Bahtiri nderon me mirënjohje drejtorin e Prokurimit

Mitrovicë, 29 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka nderuar me një mirënjohje drejtorin e Prokurimit, Bekim Muja, pas vlerësimit të bërë nga Instituti Demokratik i Kosovës, duke e renditur Komunën e Mitrovicës në vend të parë për gjysmëvjetorin e parë të vitit 2018, për transparencë në prokurim publik. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka thënë se ndihet i lumtur dhe krenar që komuna që ai udhëheq është vlerësuar me numrin më të madh të pikëve në kuadër të këtij projekti. Ai ka falënderuar drejtorin Muja dhe stafin e tij për punën e tyre të palodhshme në shërbim të qytetarëve. Po ashtu, kryetari Bahtiri ka shprehur gatishmërinë e tij që transparencën komunale ta ngrehë edhe më tutje duke vënë në dispozicion të gjitha dokumentet që janë të nevojshme dhe në interes të qytetarëve.
Ky vlerësim është bërë në bazë të raportit nga metodologjia e matjes së transparencës në fushën e prokurimit publik për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, për kryeqytetin dhe 37 komunat e Kosovës nga Instituti Demokratik i Kosovës. Në këtë raport Komuna e Mitrovicës ka arritur të renditet në vendin e parë me pikët e përgjithshme 92.69 për qind.

# Prishtina me marrëveshje për përmirësimin e mirëqenies sociale të fëmijëve bonjakë

PRISHTINË, 29 MARS (ER) - Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi, dhe drejtori i organizatës "Qatar Charity", Mahmoud Shaker, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të përmirësimit të mirëqenies sociale dhe ekonomike të fëmijëve bonjakë të kësaj komune. Organizata "Qatar Charity" do të përkujdeset që fëmijët të marrin mbështetje edhe për shkollim, kujdes shëndetësor dhe avancim profesional, duke iu ofruar mundësi të barabarta për integrim në shoqëri.



# Kush është pengesë për bashkimin e shqiptarëve?!



Bedri ISLAMI

Në ditët e fundit, dy institucionet kryesore të sigurisë, i Shqipërisë dhe i Kosovës, por edhe struktura të rëndësishme jashtë tyre që, po ashtu, monitorojnë zhvillimet në të dy shtetet, kanë bërë sondazhe përkatëse rreth dëshirës së shtetasve respektivë në dëshirën e tyre për bashkimin në një shtet të vetëm.
Pas shumë deklaratave politike të liderëve në të dyja anët e kufirit, herë deklarata thjesht politike, më shpesh kontradiktore e rrallëherë ashtu si duhet, ka qenë e domosdoshme të shkohet edhe përtej tyre, pra të njësohet në një mendim të arsyetuar ajo që deklaronin njerëzit e politikës, me atë që duan njerëzit e zakonshëm. Konkluzioni ka qenë i papritur dhe, për disa struktura jashtë shteteve shqiptare, ka qenë disi qetësues.
Rreth 28 për qind e banorëve të Shqipërisë londineze e kanë parë si një e ardhme e natyrshme bashkimin kombëtar, ndërsa në shtetin e Kosovës ka qenë disi më lart, rreth 33 për qind.
Një përqindje e tillë, në të dyja anët e kufirit, ka qenë dërrmuese për politikën, e cila, si edhe herë të tjera, ka menduar e vazhdon të mendojë se mjafton deklarimi apo shpallja e vetvetes patriotë i dorës së parë dhe gjithçka tjetër do të ishte e bindshme, e pastër, e urtë dhe e sigurt.
Shifrat kanë qenë dërrmuese për shumë njerëz të cilët kanë pritur shumë më ndryshe dhe kanë qenë të përkëdhelur nga ideja e bashkimit të shqiptarëve, mes të tjerëve, edhe për autorin e këtij shkrimi, i cili, në një moment të veçantë të jetës së tij, u bashkua me lëvizjen çlirimtare në Kosovë, pikërisht se aspironte dhe kishte programuar në mendimin politik, bashkimin e kombit.
Përse po ndodh kjo ndarje mes njerëzve të një kombi? Cila dhunë apo trysni është ushtruar mbi mendimin e tyre, që ka çuar drejt regresit një dëshirë të kamotshme? Kur kam takuar për herë të parë një njeri të moshuar nga Gjilani, që kishte ardhur tek i biri, kam dëgjuar nga ai përbetimin: "Pasha atë kohë kur kem kenë Shqypni!", megjithëse kishte qenë kohë pushtimi.
Në zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri, mars 1991 dhe mars 1992, të gjitha partitë politike shqiptare në programin e veta kishin vënë bashkimin kombëtar, bile lideri i PD-së, Berisha, duke shkuar edhe më tej, e shpallte bashkimin çështje ditësh a muajsh. Mjaftonte të fitonte partia e tij.
Asnjëra nga këto forca politike nuk e kishin përgatitur popullin për bashkim, sepse duke qenë, thuajse, të gjithë nga trupat drejtuese, komunistë të skalionit të dytë, ose ishin të padukshëm, ose nuk kishin as forcën dhe as mundësinë ta shpallnin opsionin e tyre politik.
Shqiptarët në Kosovë, para vitit 1990, vraponin me orë të tëra, nganjëherë edhe natën ecnin, rrugë e pa rrugë, që të ishin në auditore për t'i dëgjuar ligjëratat e Çabejt, Budës, Kostallarit, të shikonin Kadarenë, Agollin, të këndonin e kërcenin me ansamblet e Shqipërisë, të qanin, të dhuronin, të lumturoheshin se kishin prekur pak tokë Shqipërie.
Tani gjithçka është e hapur. Mund të shkosh të pish një kafe në Prizren, të drekosh në Mitrovicë dhe në mbrëmje të pushosh në Durrës.
Ishte hapja shkaku i ftohjes? Mos vallë, duke u njohur edhe u ftohëm nga njëri-tjetri?
Viti 1999, viti i dëbimit masiv të shqiptarëve të Kosovës nga hordhitë serbe, dëshmon se nuk ishte e nuk mund të jetë njohja. Ndoshta ishte shfaqja më madhore e dëshirës për jetë të përbashkët, për halle e dëshira të përbashkëta. Ishte viti monumental i bashkimit, kur kufijtë ranë, kur u njësua mendimi dhe u përballua një situatë, e cila, po të kishte ndodhur në ndonjë vend tjetër, me siguri nobelistët do të kishin nderuar qytetin kufitar, si Kukësi, me çmimin e tyre. Dhe do ta kishin pasur për nder.
Me joshjen e bashkimit politikanët luajnë shpeshherë si me karta të njohura. Këto karta, pas nji sondazhi, po bien. Tani vetëm një forcë politike ka në programin e saj idenë e Bashkimit, Lëvizja VV, ndërsa të tjerat e kanë hequr atë që në zgjedhjet e majit të vitit 1996. Aty filloi edhe rënia. Asnjë forcë politike nuk e vendosi më bashkimin dhe, rastësisht, në këtë prag zgjedhjesh, duke u takuar me liderë të njohur të PD-së, Pjetër Arbnori, dhe të PS-së, Shaqir Vukaj, kryetar dhe nënkryetar të Kuvendit të Shqipërisë, që të dy, njëri nëpër dhëmbë dhe tjetri sinqerisht, pranuan se, vendosja e këtij nocioni i dëmtonte në votimet e ardhshme.
Shkaku themelor nuk është tek njerëzit e zakonshëm. Viti 1999 i ka bashkuar njerëzit dhe, ende sot, miqësia e atyre javëve dhe muajve i ka qëndruar kohës.
Ndarja erdhi nga njerëzit e politikës, të cilët, sa më shumë çirreshin për bashkim, aq më shumë e largonin bashkimin dhe e largojnë ende.
Alibia, se pas kësaj shkëputje qëndron politika e Berishës, është e njëanshme dhe jo e plotë. Është e vërtetë se pikërisht me ardhjen e tij në pushtetin presidencial, në Shqipëri vërshuan dhjetëra e dhjetëra bashkëpunëtorë të shërbimit të fshehtë serb që, mes të tjerave, kishin edhe misionin e shkatërrimit të idesë së bashkimit, qoftë edhe shpirtëror, por kjo nuk do të ishte e mjaftueshme.
Berisha është fajtori i madh, por jo i vetmi. Ai do të mbetet njeriu i politikës që synoi, qoftë edhe me forcë, të depërtonte në politikën e shqiptarëve të Kosovës, të huaj si paternalisti më i madh dhe atdhetari më i shquar, nacionalist i dorës së parë dhe përdori dhe u mbështet tek antikombëtarët dhe një brez titist i pashoq në ndërrimin e ndjenjës kombëtare.
Duke mos qenë i vetmi, ai, Berisha, e shpërpjeton fajin tragjik me liderët e tjerë, që aq shkujdesshëm dhe paturpësisht, përtallën idenë, shkelën mbi një të drejtë të natyrshme, duke krijuar tarafe politike dhe jo ndjenjë përbashkuese.
Në Kosovë kjo u bë qëllimisht, me çdo gjë të planifikuar, që nga ndërtuesit e parë të Lidhjes Demokratike, që u ngrit në zyrat e gazetës "Rilindja", organi zyrtar i Lidhjes Komuniste, nga pesë gazetarë, katër nga të cilët ishin bashkëpunëtorë të Sigurimit të fshehtë serb, njëjtë sikur PD-ja të krijohej nga pesë gazetarë të "Zërit të Popullit", komunistë të devotshëm, si Balliu me të tjerë, që tani përfitojnë bonuset e trashëgimisë përdhosëse njerëzore.
Në Kosovë ka qenë e domosdoshme të zhbëhej miti i Shqipërisë, si vendi ku, në një moment vendosës, mund të kishe shpatullat e mbështetura, si një triumf i forcave titiste e udbashe në udhëheqjen e tyre politike dhe si dërrmim i qindra njerëzve të dënuar për irredentizëm dhe përpjekje për bashkim me Shqipërisë, të cilët, së bashku, në 50 vite titizëm, bënë më tej se 122 mijë vite burgim dhe lanë pas 41 mijë të vrarë.
Në Shqipëri, ku lobi serb ishte i pranishëm, qoftë në sallën e parlamentit apo në qeveri të ndryshme, si është rasti i "Pashtrikut" që arriti të jetë edhe zëvendësministër i Mbrojtjes, Kosova vazhdoj të shihej si një domen, përmes së cilës mund të influencohej në politikën e jashtme; ajo përdorej si një gur shahu që mund të lëvizte sipas dëshirës së Tiranës dhe që dërmohej në Prishtinë.
Kjo duhmë politike solli mendimin në Kosovë se, mes dy forcave politike, PD-së dhe PS-së, fillimisht të zgjidhnin të parën, sepse u dukej më nacionaliste, më pranë tyre, më veriore, kur në fakt do të jetë e kundërta: kohë kur qeveriste e majta, janë edhe ato të pranisë më të madhe të mendimit të përbashkët.
Politika është ajo që dërmon vizionin e rilindësve dhe përpjekjet e burrave të shtetit. Edhe sot ajo është e ndarë në parcela, të cilat, po të ndjekësh rrugëtimin drejt tyre, nuk të çojnë në asnjë fryt të dobishëm.
Kemi dyshe të krijuara gjithandej: Rama me Thaçin, dhe kush e qorton apo e shan këtë të fundit, është "gomar"; në kahun tjetër Meta dhe Haradinaj, Kurti kërkon një partner dhe, megjithëse shpalli pranverën shqiptare, në të vërtetë do të ishte një antipranverë shqiptare, shumë vetë besojnë tek ai.
Si mund të kërkohet një bashkim shqiptarësh me këtë klasë parapolitike që kemi; me brejtës të pasurisë dhe gëlltitës të vlerave të mëdha; një klasë politike që akuzon njëra tjetrën për vrasje, vjedhje, tradhti kombëtare, shitje tek serbi, tek greku; një pari politike që gjithë atë ëndërron Amerikën dhe në mëngjes i kërleshet asaj; njerëz të politikës që bëjnë namin në Beograd dhe tkurren në Tiranë; politikanë të vjetër që dyshohen me një nisje serbe dhe sjellin në udhëheqje pinjollë të lidhur me bosat e fushës kriminale dhe politike të shërbimit të fshehtë serb; një klasë politike që sjell në Shqipëri apo dërgon në Kosovë figura të rënduara nga e shkuara me shërbimet politike të një kohe të shkuar?
Ne kemi njerëz të pasur të politikës, ndoshta më të pasurit në Ballkan, kur të gjithë e kanë filluar nga zeroja e para pak viteve, të cilët, ndërsa takohen me njëritjetrin, më shumë i rëndojnë temat e bisedave nga tenderët sesa nga njerëzit. Për njerëzit të politikës që nuk bëhen njerëz, këto nuk mund të ngjallin besim se mund të kemi një të ardhme të përbashkët.
Sepse njerëzit më shumë mendojnë se të shpëtojnë prej tyre sesa të bien nën një "zgjedhë" të dyfishtë.
Askush nuk është i fajshëm në anketimet e fundit.
Ai ka vetëm një emër: klasa parapolitike shqiptare, në dyja anët e kufirit, e cila, kur të mos jetë më në politikë, mund të frymojnë të tjerët.



## Parlamenti britanik edhe një herë kundërshton marrëveshjen për Brexit

LONDËR, 29 MARS - Ligjvënësit britanikë kanë kundërshtuar për herë të tretë marrëveshjen e kryeministres britanike, Theresa May, për largimin e Britanisë nga Bashkimi Evropian.
Në votimin e së premtes, është përfshirë çmimi i Brexitit, të drejtat e garantuara për qytetarët britanikë dhe ata të Bashkimit Evropian, detajet e periudhës 21-mujore të transicionit dhe diskutimet për kufirin irlandez. Kjo pjesë e marrëveshjes nuk ka përfshirë marrëdhënien që do ta ketë Britania me BE-në, pasi të përfundojë procesi i Brexitit.
Ndërkohë, vetëm në Londër pritet të organizohen 13 protesta, meqë 29 marsi është dita kur fillimisht ishte caktuar largimi i Britanisë nga BE-ja.
Shefi negociator i BE-së për procesin e Brexitit, Michel Barnier, ka thënë para votimit se procesi i së premtes është shumë i rëndësishëm.
Prokurori i përgjithshëm, Geoffrey Cox, u ka thënë ligjvënësve britanikë se marrëveshja duhet të miratohet para orës 23:00 të së premtes, nëse Britania dëshiron të fitojë "të drejtën ligjore" për shtyrje të Brexitit, megjithatë deputetët britanikë e kanë kundërshtuar marrëveshjen.



# Presidenti Trump, në sulm kundër demokratëve

Presidenti Trump u hodh në sulm të ashpër ndaj atyre që mbështetën hetimet e prokurorit të posaçëm gjatë një tubimi në Miçigan, në veçanti ndaj ligjvënësve demokratë me peshë që kanë thënë se hetimet mbi presidentin, fushatën dhe bizneset e tij, do të vazhdojnë

UASHINGTON, 29 MARS - Presidenti amerikan Donald Trump është hedhur në sulm qëkur u përmbyll raporti mbi hetimin dyvjeçar për lidhjet me Rusinë në prag të zgjedhjeve presidenciale të 2016-s. Raporti i prokurorit të posaçëm Robert Mueller nuk nxori aktivitet të paligjshëm nga ana e presidentit.
Presidenti Trump po u kushton vëmendje të veçantë demokratëve që janë shprehur se raporti nuk konfirmon pafajësinë e presidentit.
Presidenti Trump u hodh në sulm të ashpër ndaj atyre që mbështetën hetimet e prokurorit të posaçëm gjatë një tubimi të enjten në mbrëmje në Miçigan. Ai u përqendrua në veçanti te dy ligjvënës demokratë me peshë që kanë thënë se hetimet mbi presidentin, fushatën dhe bizneset e tij, do të vazhdojnë, mbi kreun e Komisionit mbi Shërbimet e Zbulimit, Adam Schiff dhe kreun e Komisionit për Gjyqësorin, Jarry Nadler. "Shumë njerëz u dëmtuan rëndë nga kjo skemë mashtruese, por ajo që është edhe më e rëndësishme është se u dëmtua vendi. Tani ata po e mbajnë veten me bombol oksigjeni. Adam Schiff me qafë të hollë. E pashë sot kur po thoshte "Nuk e dimë vërtet. Mund të ketë pasur bashkëpunim me rusët". Është



e neveritshme. Këta janë njerëz të neveritshëm", tha presidenti.
Megjithëse raporti i prokurorit Mueller nuk është bërë publik, presidenti thotë se përfundimet e raportit e nxjerrin plotësisht të pafajshëm. "Prokurori i posaçëm e përfundoi raportin dhe nuk ka zbuluar bashkëpunim të fshehtë apo pengim të drejtësisë. Këtë përfundim e kishit nga unë dy vjet e gjysmë më parë. Dola plotësisht i pastër, plotësisht i shpaguar", tha presidenti Trump.
Në përmbledhjen e tij me katër faqe, prokurori i përgjithshëm, William Barr, thotë se "raporti nuk arrin në përfundimin se presidenti ka kryer akte të paligjshme por, gjithashtu, nuk konfirmon pafajësinë". Por, kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, thotë se përmbledhja e prokurorit të përgjithshëm nuk mjafton dhe se demokratët duan ta lexojnë raportin e plotë. "Duam t'i shohim faktet. Duam të shohim çfarë ka raporti. Nuk na duhet fjala apo interpretimi i prokurorit të përgjithshëm, i cili, para se ta merrte këtë detyrë, tha se presidenti është mbi ligjin, apo kur tha se nuk mendon që ndaj një presidenti amerikan mund të ngrihet aktpadi", tha Pelosi.
Fillimisht presidenti Trump u bëri jehonë thirrjeve të demokratëve për publikimin e raportit në formë të plotë. Por deklaratat e Trumpit në adresë të demokratëve flasin për një thellim të përçarjeve politike në Amerikë, ndërkohë që demokratët përgatiten për betejë kundër presidentit në zgjedhjet e nëntorit 2020.

# Stoltenbergu, shef i NATO-s deri në vitin 2022

BRUKSEL, 29 MARS - Jens Stoltenberg, 60-vjeçar, i cili mori detyrën më 1 tetor të vitit 2014, do të shërbejë në këtë post deri më 30 shtator të vitit 2022.
Diplomatët thonë se ai është mjaft popullor në mesin e aleatëve, posaçërisht në sytë e presidentit amerikan Donald Trump, i cili e ka vlerësuar atë për ndihmën që ka dhënë në shtimin e shpenzimeve evropiane të mbrojtjes.
Në një njoftim nga selia e NATO-s thuhet se "aleatët shprehën mbështetjen e tyre për punën e sekretarit të përgjithshëm për ta




përshtatur dhe modernizuar NATO-n dhe për të siguruar që ajo të mbetet e tillë për të ardhmen".
NATO-ja që dikur është parë nga disa si relikt i Luftës së Ftohtë, rifitoi rëndësinë derisa Perëndimi po i kundërvihet Rusisë së ringjallur, sulmeve kibernetike të mbështetura nga shtetet, kërcënimeve të sigurisë në kufijtë e saj dhe sulmeve militante në qytetet evropiane.
Nëse e përmbush mandatin, Stoltenbergu do të jetë shefi i dytë i NATO-s që shërben më së gjati pas ish-ministrit të Jashtëm holandez, Joseph Luns, që shërbeu si sekretar i përgjithshëm nga tetori i vitit 1971 deri në maj të vitit 1984.
Stoltenbergu u shpreh i nderuar me vendimin e 29 aleatëve të NATO-s. "Së bashku do të vazhdojmë të modernizojmë aleancën që të jetë e gatshme për të ardhmen", tha ai.
Javën që vjen Stoltenbergu do të qëndrojë në Uashington ku do të drejtojë takimin e ministrave të jashtëm të NATO-s në shënimin e 70-vjetorit të Aleancës. Gjatë asaj kohe ai do të takohet me presidentin Donald Trump dhe do të mbajë fjalim në Kongresin amerikan.
Njëzet vjet më parë NATO-ja kishte shënuar 50-vjetorin e themelimit në mes të fushatës së bombardimeve ndaj Serbisë, për t'u dhënë fund mizorive të forcave serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës.

## Incident i sigurisë në Ambasadën e ShBA-së në Mal të Zi

PODGORICË, 29 MARS - Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Podgoricë e ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se një person ka tentuar të hyjë në oborrin e ambasadës dhe se policia malazias ka reaguar menjëherë. "Sot rreth orës 10:45 një person ka bërë përpjekje të hyjë në oborrin e Ambasadës së ShBA-së në Podgoricë. Pjesëtarët e sigurimit kanë reaguar menjëherë duke e ndaluar dhe dorëzuar tek autoritetet e Policisë së Malit të Zi. Falënderojmë partnerët tanë të Malit të Zi për ndihmën dhe përkrahjen", thuhet në përgjigjen e Ambasadës amerikane në Podgoricë.
Pas këtij incidenti, pjesëtarë të Policisë Speciale kanë bllokuar edhe rrugën përreth ambasadës. Gazeta "Vijesti" ka raportuar se sigurimi i Ambasadës së ShBA-së ka reaguar pasi një grup i azilkërkuesve kanë bërë përpjekje të hyjnë në objekt.









# BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.






E jashtëzakonshme

## Hëngri mish të papjekur, adoleshenti vdes nga paraziti në tru



Një 18-vjetar nga India humbi jetën pasi hëngri mish të papjekur derri, gjë që i shkaktoi një larvë parazitare në tru. Adoleshenti nga India shkoi me urgjencë në spital pasi humbi ndjenjat nga krizat e epilepsisë. Pas një skaneri, mjekët zbuluan se kishte kiste në të gjithë trurin, që i shkaktoi gjendjen kërcënuese për jetën 'neurocysticersosis'.

FOTO E DITES




Një poster gjigant i presidentit turk që mbulon fasadën e një ndërtese shihet nga një dritare e dyqanit ku shfaqen modelet e parukalive në Stamboll. /AFP/

E rrallë

## Në këtë shtet do të dënohen me vdekje shoferët e dehur




Tajvani po planifikon t'i rrisë dënimet për shoferët që drejtojnë makinën në gjendje të dehur dhe shkaktojnë aksidente fatale. Në rastet tragjike mund të përfshihet dënimi me vdekje. Kabineti qeveritar ka miratuar të enjten një projektamendament të Kodit Penal që e bënte vdekjen e shkaktuar nga shoferi i dehur një vepër të dënueshme me vrasje.

BARSOLETA E DITËS



**Në një qebaptore në Gjakovë:**
**- Kamerier, a mund të më japësh një rrëmojëse?**
**- Jo, se kurrë s'po i kthen.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 16:00**

**"HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D**



I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



**Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)**

**"THE KID WHO WOULD BE KING",**

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish

**Në ora 20:00**

**"CAPTAIN MARVEL" 3D**



Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

**Rolet:** Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

**Regjia:** Anna Boden, Ryan Fleck




**Në ora 22:00**

**"U S"**

Horror/Triller; 1 ore 56 min

**Rolet:** Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon
**Regjia:**Academy Award®-winning visionary Jordan Peele

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Do të kaloni një ditë të hareshme dhe të qetë me disa çaste të këndshme humori. Hëna në shenjë ju bën altruist me të tjerët.



**DEMI**
Ndjenja e tepruar e krenarisë sot do t'ju nxjerrë antipatike në sy të miqve. Nuk do të pranoni të bëni kompromise edhe kur ta kuptoni që mund të keni gabuar.



**BINJAKËT**
Edhe pse mjaft nervoz, sot duhet ta gjeni ekuilibrin tuaj të brendshëm. Nuk mund të shpërtheni në çdo çast edhe kur nuk është e nevojshme.



**GAFORRJA**
Intuita dhe kreativiteti juaj do t'ju japin shumë favore në ambientin e punës. Do të dilni të ofroni zgjidhje shumë efektive për eprorët tuaj.



**LUANI**
Sot në rrugën tuaj do të ndeshni me dikë që është mjaft i prirë t'ju ndihmojë. Keni nevojë për një person që t'ju këshillojë dhe do të ndiheni të lehtësuar.



**VIRGJËRESHA**
Merrni kohë për të menduar përpara se të paragjykoni të tjerët. Këto ditë nuk jeni mjaft të qetë për të pasur një vizion të qartë të gjërave.



**PESHORJA**
Po e çlironi fantazinë sot në gjithçka që ju bën mirë dhe është argëtuese. Do të tërhiqni në orbitën tuaj njerëz me tipare të forta egoizmi.



**AKREPI**
Sot ndiheni romantik dhe çdo gjë e lidhni me kujtime të bukura të marrëdhënies tuaj në çift. Do të keni një lajm nga një person që nuk e prisni.



**SHIGJETARI**
Sot keni shumë gjëra për të bërë dhe për të organizuar. Në rrëmujë e sipër do të harroni detaje që më vonë do t'ju prishin punë.



**BRICJAPI**
Në familje dhe në lidhjen në çift do të keni probleme për ta menaxhuar mbarëvajtjen e ditës. Për çdo gjest tuajin do të hasni në kundërshtime.



**UJORI**
Sot nuk do t'i keni punët mirë me paratë. Do të shpenzoni edhe për gjëra që nuk i kishit planifikuar dhe do t'ju krijohen disa debite të njëpasnjëshme.



**PESHQIT**
Në një ambient të ri do t'ju marrin me sy të mirë që në ditën e parë. Mundohuni të lini të njëjtën përshtypje edhe më tutje.

# Nicolas Cage kërkon divorc pas katër ditësh martesë



Nicolas Cage dëshiron t'i japë fund martesës vetëm katër ditë pasi ka kurorëzuar dashurinë e tij me Erika Koike. Sipas dokumenteve që "The Blast" i ka siguruar, Cage ka kërkuar anulimin e martesës me Koike. Javën e kaluar mediat kanë raportuar se aktori kishte aplikuar për kurorëzim në Clark County të Nevadës, por duket se martesa tashmë veç se kishte ndodhur.

# Hailey Baldwin mban me krenari mbiemrin e burrit në kapele




Hailey Baldwin dhe Justin Bieber po vazhdojnë ta mbështesin njëri-tjetrin dhe martesën e tyre. Dy ditë pasi këngëtari 25-vjeçar iu përgjigj fansave që po e godasin bashkëshorten e tij në rrjetet sociale, Baldwin është parë në West Hollywoo, duke iu kujtuar të gjithëve për mbiemrin e saj të ri. 22-vjeçarja është fotografuar e veshur me sutjena sportive dhe pantallona të shkurtra, por edhe e ka festuar dashurinë e saj. Modeluesja kishte vënë në kokë një kapele të zezë ku ishte i shkruar mbiemri i bashkëshortit të saj me shkronja ngjyrë ari (Bieber).



# Adele po sjell këngën e saj të re

Këngëtarja e hitit "Hello", Adele, u pa të mërkurën në një studio regjistrimi në Nju Jork. Ajo duket se po sjellë këngën e re për të gjithë adhuruesit e saj. Adele u paraqit rrugëve me një xhaketë të trashë dhe të zezë me kapele në kokë.

# A është ndarë Wendy Williamsi?



Prezantuesja televizive Wendy Williams para disa dite ka mohuar akuzat se kishte probleme martesore. Sipas "People", të enjten ajo u fotografua nga paparacët teksa dilte nga studioja e punës në Nju Jork, dhe dukej që Williamsi nuk e pati në dorë unazën e martesës. "People" më tej shkruan se kjo është një nga shenjat e para që tregon se Wendy mund të ndahet nga bashkëshorti Kevin Hunter.




Autor: GAZMEND MORINA

- SABOTAZHET
- PËRHAPJE E VALËVE
- MUZIKANTI ..... KISERI (shq.)
- TË FIKËT
- NORA ISTREFI
- ZANORE
- EPOKA E RE
- HEROI NË FOTO 2
- SHKENCA QË STUDION MORALIN
- MINDERI I ULËT (krah.)
- PËREMËR PRONOR
- KRIPË E ACIDIT NITRIK
- LUMË NË SHQIPËRI
- TENISTJA BELGE JUSTINE / GLOBAL ARBITRATION REVIEW
- BAR PËR TË DALË JASHTË (shq.)
- GATESA / BASHKËT.
- AKTORI HOLLIVUDIAN ... STILLER (shq.)
- NDESHJET / ANA RUSO
- KRYEQYTETI I KANADASË
- KËNGËTARI PORTORIKAN .... MARTIN / ISMET JASHARI
- ROSTOCK / NJË LLOJ BUFI
- VOZË E MADHE DRURI QË SHËRBEN PËR TË MBAJTUR DJATHË (shq.)
- NOTË MUZIKORE / ZANORE
- KAPËRDIJ / KOD I TELEFONIT MOBIL
- INTENSITET, METËR; INDIUM
- VIJË QË SHPIE UJIN NË MULLI
- A
- IDHULL / RAMADAN (perkdh.)
- EPOKA E RE
- HEROI NË FOTO 1
- ARKEOLOGU SHQIPTAR SKËNDER
- GJUMI I THELLË (med.) / ARKA PREJ HEKURI KU RUHEN PARA
- BASHKËT. / NIKEL, AZOT




- ALBANOLOGIA .... DURHAM
- PUSULLAT
- TRADITË, ADET (sh.pashq.)
- ISH FUTBOLLISTI ÇEK ... KOLLER (BORUSSIA DORTMUND)
- ZANORE / KËNGËTARI AMERIKAN .... BROWN (shqip.)
- BANOR I VIETNAMIT TË VJETËR
- SHKRONJA TË NJËJTA
- KASTRIOT TUSHA / VEPRIMTARI I SHQUAR ...... BEQIRI
- PATRIOTI YNË PRISHTINA
- NË ÇFARË MASE
- ZANORE
- JO I VJETËR / JETËSHKRIM
- GRIMCOVA (bised.)
- UGANDA, TANZANIA
- SIENA / MALLKOJ
- LLOJ PJEPRI I VERDHË
- AKTORI YNË NASER ......
- BANORE E HERSHME E NJË KRAHINE
- I MBUSHUR TËRËSISHT; I .....
- KUVENDI I KOSOVËS
- HOUSING AGENCY JAMAICA
- BASHKËT. / MARC ANTHONY
- AJËR (ang.)
- MITRUSH KUTELI / PARIM I QARTË E I PËRCAKTUAR MIRË
- AMERICAN PUBLIC MEDIA
- TEDI ALVES
- SHKENCA QË STUDION MORALIN
- TREVISO
- BOTIMI
- DIJETAR FETAR MYSLIMAN / TANI
- BASHKËT.
- TINKA KURTI / NJË STINË
- BRINJËT E NJË TREKËNDËSHI / PËREMËR PRONOR
- SHTET (huaj)




- DËMTIM I NJË MEKANIZMI GJATË LËVIZJES
- PËRFUNDIM NË SHAH / FILM I YNI "... ISHIN KATËR"
- DRITËRO AGOLLI / FUTBOLLISTI DANIELE (MILAN)
- ZAMBIA, ESTONIA
- I PARI I XHAMISË (pashq.) / ISH FUTBOLLISTI ..... SHAQIRI
- EMËR MASHKULLI MYSLIMAN / BASHKËT.
- PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA (vjet.)
- FUTBOLLISTI ANGLEZ .... PARKER (TOTENHAM) / GJYMTYRË E TRUPIT
- NGASËSI I "Formula 1" .... HAKINEN
- ISH FUTBOLLISTI IGLI ....
- ALFRED KAÇINARI / PJESËTAR I AONËVE
- MBAJTJE E ANËS / TRAJNERI GJERMAN REHAGEL
- INTER
- DIREK I ÇATISË / SHKRONJA TË NJËJTA
- "RODA" / RIADI, DAKARI
- ISH SOLISTJ ANGLEZE WINEHOUSE (shqip.) / OSMAN XHAKA
- EPOKA E RE
- KAM NJOHURI PËR DIÇKA / ZANORE
- QË KA TË BËJË ME ORATORINË / OSAKA
- HEROI NË FOTO 3
- ZANORE

# Pesë sekretet e filmit “Pretty Woman” dhe dyshja Pacino-Pfeiffer!

Më 23 mars 1990, filmi sapo doli dhe u bë menjëherë një sukses global. Meritë gjithashtu e duetit Richard Gere dhe Julia Roberts pak të njohur, protagonistët e një përralle për të rritur.

### Historia e një biznesmeni dhe një prostitute

Një biznesmen i pasur Hollivudi, Edward Lewis, paguan një eskortë, Vivian Ward, për një javë shoqëri. Natyrisht, ai është Richard Gere, tashmë një ikonë e bukurisë, ndërsa ajo është shumë e re, njëzet e një dhe pak e njohur, Julia Roberts: më 23 mars 1990, me ardhjen në ekranet e “Pretty Woman” nga Garry Marshall, ata bëhen një çift i paharrueshëm për shumë spektatorë. Biznesmeni i akullt ndoshta fsheh një zemër prej ari, ndërsa ajo është e papërmbajtshme për hijeshi dhe karizëm: a do të jenë princ dhe princeshë? Historia e tyre e dashurisë, e filmuar tërësisht në vendndodhjen në Hollivud, kryeqyteti i ëndrrave par excellence, bëhet një kulti shumë i suksesshëm, në ritmin e këngës së Roy Orbison. Julia Roberts zyrtarisht bëhet një yll, me shumë nominime të Oskarit dhe miliona zemra ndriçojnë për një përrallë të rriturish, jetuar me një frymë romantike.

### “Pretty Woman” ishte fillimisht një dramë

Me një kosto prej 14 milionë dollarësh, “Pretty Woman” shiti 463.4 në botë, duke u bërë një nga komeditë më të famshme romantike ndonjëherë. Megjithatë, fillimisht, skenari nga J.F. Laëton ishte krejt ndryshe: ajo quhej “$ 3,000” dhe ishte një dramë e dedikuar për marrëdhëniet midis një prostitute të droguar nga kokaina dhe një biznesmeni me një përfundim surreal në Disneyland. Skenari, i zhvilluar në Festivalin e Filmit Sundance, kishte një garanci për cilësinë, por kur kompania e parë që kishte të drejtat dështoi, skenari u mor nga Touchstone, një markë Disney. Kompania e prodhimit vendosi të mbajë shumë skena dhe linjat thelbësore të komplotit, por të ndryshojë rrënjësisht tonin e saj. Të paktën katër krijues të tjerë jo të akredituar u përfshinë, duke e shndërruar dramën në një komedi sentimentare, të frymëzuar nga “Pigmaglione” e George Bernard Shaw dhe, natyrisht, Hirushja. Në pritje, deri në ditën e fundit të xhirimeve, mbarimi i filmit mbeti, i zgjidhur nga prodhuesi Laura Ziskin.

### Julia Roberts, pjesa e parë si yll dhe një gjerdan

Shumë aktorë u provuan për pjesën e Vivian Ward, midis Meg Ryan dhe Michelle Pfeiffer më të famshme, por më në fund ishte regjisori Garry Marshall, i cili u përqendrua tek e reja Julia Roberts, të vlerësuar në “Pizza Mystic” (1988) në një rol dramatik, por ende jo shumë i famshëm. Drejtori e kuptoi aftësitë e saj të shkëlqyera komike, dhe në grup, së bashku me Gere, ai gjithmonë u përpoq që ta bënte të ndihej e qetë. Tensionet ishin të lidhura me skenat seksuale dhe Gere një herë, për shkak të solidaritetit me aktoren që ishte gjithmonë gjysmë e zhveshur, u shfaq lakuriq. Një nga skenat më të suksesshme është ajo në të cilën Edward i ofron Vivian një gjerdan të vlefshëm për një mbrëmje gala dhe papritmas mbyllet kutia që e përmban atë. Gjesti u improvizua, reagimi i natyrshëm, por askush në kinema nuk e di se jashtë fushës, një roje private mbajti xhevahirin që ruante aktorët: gjerdani ishte me vlerë 250,000 dollarë.

### Richard Gere: Një rol i bërë me porosi

Për rolin e Edward Luis disa aktorë u kontaktuan dhe më afër për të marrë pjesë, aq shumë saqë një version ad hoc i shkrimit është shkruar vetëm për të, ishte Al Pacino. Audicionet e tij nuk e bindën plotësisht dhe regjisori Marshall u përpoq ta dërgonte skenarin te Richard Gere, në një kohë të bllokimit në karrierën e tij, i cili vite më vonë kujtoi: “Ishte një skenar i frikshëm dhe i parëndësishëm, por kur ajo arriti, pjesa dukej si një fustan i qepur. Në praktikë, ishte e mjaftueshme për t'u futur dikush në të”. Gere ishte i dyshimtë, por Marshall dhe Roberts shkuan ta takonin në shtëpinë e tij në Nju Jork për ta bindur atë. Gjatë takimit, ai e thirri producentin dhe ndërsa aktori ishte në telefon, Julia Roberts shkaktoi bashkëpunimin e parë duke i shkruar atij në një copë letre: “Ju lutem, po”. Ftesa u pranua.

### Garry Marshall, maestro komedie dhe një poster i rremë

Garry Marshall, mjeshtër i komedive sentimentale që vdiq në vitin 2016, ka punuar gjithmonë me aktoret e bukura dhe, në këtë drejtim, në intervistën e tij të fundit ka thënë: “Më pëlqejnë dhe argëtohemi. Unë kam një grup shumë të hapur, ku mund të sjellin të afërm dhe shokë, por mund të qëndroj një natë për të rregulluar një batutë nëse nuk i bind ata ose nëse nuk u pëlqejnë dritat e caktuara, unë i heq. Është thelbësore që ata të kenë sukses në film dhe, sigurisht, që ata të pëlqehen”. Natyrisht, pëlqimi ndihmon vetëvlerësimin e aktorëve, edhe pse është kureshtare të theksohet se për të nisur filmin një poster u përdor që sot ne do të thoshim “i rremë”: në të vërtetë, Gere ka flokë të zeza në poster, ndërsa ai është i thinjur në film, dhe Julia Roberts është një fotomontazh. Fytyra është e tij, por trupi është ai i Shelley Michelle, qëndrimi i saj për disa detaje seksi.

*Gazeta Shqip*















Sport




# Batatina rikthehet me fitore, Drita mposhti Ferizajn

Tahir Batatina është rikthyer me fitore në krye të shtabit teknik në skuadrën e Llapit, kurse kjo e fundit e mposhti Lirinë (0-4). Të premten fitores si mysafire i është gëzuar edhe Drita e Gjilanit që e mposhti Ferizajn (1-2)

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



PRISHTINË, 29 MARS - Skuadra e Llapit e vazhdon fuqishëm ndjekjen e titullit të kampiones në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi të premten e mposhti me rezultat bindës Lirinë në Prizren (0-4). Llapi ishte skuadër më kërkuese dhe arriti ta shënojë golin e parë në minutën e 37. Autor i golit ishte Ahmed Januzi.
Ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë realizoi edhe golin e dytë në minutën e 77, kurse katër minuta më vonë për 0-3 u përkujdes Remzi Selmani. Golin e katërt dhe të fundit në ndeshje e shënoi kapiteni Hamdi Namani (85). Në këtë ndeshje Llapi u drejtua nga Tahir Batatina, i cili e zëvendësoi trajnerin e shkarkuar Xhengis Rexhepi. Pas ndeshjes Batatina ka thënë se, po të ishte ai trajner që nga fillimi, Llapi tashmë do ta kishte siguruar titullin e kampionit. "Për mua si trajner është fitore e ëmbël pas rikthimit. Në një ndeshje të tillë me peshë është shumë me rëndësi t'i marrësh tri pikë, aq më shumë në rikthim. Me këta djem që i ka skuadra e Llapit me dhimbset koha që e kam humbur, pasi në këto çaste nuk do të ishte diskutuar titulli i kampionit. Gabimi më i madh është që nuk kam vazhduar si trajner pas organizimit të mirë që kishte klubi", ka deklaruar ai.
Pas kësaj ndeshje Llapi ngjitet në pozitën e dytë me 51 pikë, kurse Liria është e parafundit me 24 pikë. Të premten u zhvillua edhe ndeshja e dytë e vlefshme për javën e 24-t, kurse janë takuar Ferizaj dhe Drita. Kampionët në fuqi të elitës shënuan fitore me rezultat 1-2. Në minutën e 26 Qëndrim Dautaj e kaloi skuadrën vendëse në epërsi 1-0, por mysafirët nuk u dorëzuan dhe e barazuan rezultatin nëntë minuta pasi filloi pjesa e dytë nëpërmjet Kyrian Nwabueze (1-1). Kur të gjithë priten që ndeshja të përfundojë baras, në skenë doli Xhevdet Shabani që realizoi për 1-2. Pas kësaj humbje, Ferizaj e ka bërë edhe një hap pas në garën për mbijetesë, kurse Drita e forcon edhe më shumë pozitën e katërt.

**IPKO SUPERLIGA**

| | |
|---|---|
| Liria - Llapi | 1-2 |
| Ferizaj - Drita | 0-4 |

**TË SHTUNËN TAKOHEN:**
Gjilani-Trepça'89
KEK-u-Drenica

**TË DIELËN TAKOHEN:**
Ballkani-Prishtinën
Flamurtari-Feronikelin

## Gjilani kërkon fitore, Trepça '89 heshtë

Dy ndeshjet e tjera të kësaj xhiro zhvillohen sot (e shtunë). Skuadra e Gjilanit është e gatshme për ta fituar përballjen me Trepçën '89. Trajneri i ri i skuadrës së Gjilanit, Gentjan Mezani, ka thënë se është detyrë e skuadrës që ta fitojë ndeshjen e radhës, kurse ka ftuar tifozët, 'Skifterat', që të jenë në stadium për ta përkrahur skuadrën e tyre të zemrës. "Në takimin e radhës është detyrë e jona të fitojmë, sepse këtë gjë ua kam thënë edhe lojtarëve, barazimi për ne në Gjilan është humbje. Nëse do të futemi me mentalitetin e duhur mendoj se gjërat do të jenë më të lehta, por nëse mendojmë ndryshe, do të jetë e vështirë. Në këto çaste tifozët duhet të jenë lojtari i 12 sepse lojtarët kanë nevojë për ta duke parë edhe pozitat ku jemi", ka deklaruar Mezani.
Gazeta ka provuar t'i kontaktojë edhe futbollistët e Trepçës '89, por dy prej tyre kanë konfirmuar se klubi ka vendosur që ata të mos deklarohen për medie.

SHKURT

### Shefki Kuqi uron Ademin për rezultatet e përfaqësueses

